

URDHËR
Nr. 160, datë 20.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
DETAJUARA PËR OPERIMIN E PLANERAVE, SI DHE PËR LICENCIMIN E
EQUIPAZHIT TË FLUTURIMIT PËR PLANERAT, NË PËRPUTHJE ME VENDIMIN
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1095, DATË 24.12.2020, ‘PËR MIRATIMIN E
KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL’, I NDRYSHUAR”¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7 shkronja “ç”, të nenit 22, pika 4 dhe 28, pika 4 të Ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, ‘Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil’, i ndryshuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

¹ Ky urdhër përaftron plotësisht rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2018/1976 e datës 14 dhjetor 2018, për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat, në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 326, datë 20.12.2018, ndryshuar nga Rregullorja Zbatuese (BE) 2020/358 e Komisionit, datë 4 mars 2020, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 67, datë 5.3.2020.

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR OPERIMIN E
PLANERAVE, SI DHE PËR LICENCIMIN E EKUIPAZHIT TË FLUTURIMIT PËR
PLANERAT, NË PËRPUTHJE ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1095,
DATË 24.12.2020, “Për MIRATIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E
AVIACIONIT CIVIL”, I NDRYSHUAR

Neni 1

Objekti dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton rregulla të detajuara për operimet ajrore me planera, si dhe për lëshimin dhe mbajtjen e licencave të pilotëve dhe kategorizimeve, privilegjeve dhe certifikatave përkatëse për planerat, kur avionë të tillë plotësojnë kushtet e përcaktuara në shkronjat (b)(i) dhe (ii) të nenit 2(1) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme dhe, përveç nëse termat përcaktohen ndryshe në këtë nen, do të zbatohen përkufizimet e nenit 2 të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar:

1. “Planer” nënkupton një avion më të rëndë se ajri që mbështetet në fluturim nga reaksioni dinamik i ajrit ndaj sipërfaqeve të tij fikse ngritëse, fluturimi i lirë i të cilit nuk varet nga motori;

2. “Motor” nënkupton një pajisje të përdorur ose që synon të përdoret për shtyrjen e planerit me motor;

3. “Planer me motor” nënkupton një planer të pajisur me një ose më shumë motorë, të cilët me motor/ët të fikur/joaktiv kanë karakteristikat e një planeri;

4. “Operim tregtar” nënkupton çdo lloj operimi të një planeri, në këmbim të një shpërblimi/pagese ose përfitim tjetër me vlerë, i cili është në dispozicion për publikun ose, kur nuk vihet në dispozicion për publikun, që kryhet në bazë të një kontrate midis një operatori dhe një klienti, ku ky i fundit nuk ka kontroll mbi operatorin;

5. “Fluturim për gara” nënkupton çdo operim fluturimi me një planer të kryer për qëllime të pjesëmarrjes në gara ose konkurse, përfshirë stërvitjen për këto lloj operimesh dhe fluturimin në dhe nga garat ajrore ose konkurset;

6. “Shfaqje fluturuese” nënkupton çdo operim ajror me planera të kryer për qëllime të ofrimit të një shfaqjeje ose argëtimi në një event të reklamuar të hapur për publikun, duke përfshirë stërvitjen për një operim të tillë dhe fluturimin për në dhe nga eventi i reklamuar;

7. “Fluturim prezantimi/prezantues” nënkupton çdo operim ajror me një planer kundrejt shpërblimit ose një shpërblimi tjetër të vlefshëm, që konsiston në një turne ajror me kohëzgjatje të shkurtër me qëllim të rekrutimit të personave të rinj ose anëtarëve të rinj, të kryer nga organizata e trajnimit e referuar në nenin 8a të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, ose nga një organizatë e krijuar me qëllim të promovimit të sportit ajror ose të aviacionit argëtues.

8. “Fluturim akrobatik” nënkupton një manovër të qëllimshme që përfshin një ndryshim të menjëhershëm në qëndrimin e një planeri, një qëndrim jo të zakonshëm/jonormal ose një përsheptim jonormal, jo të nevojshëm për fluturimin normal ose trajnimin për kualifikimin për licenca, certifikata ose kategorizime, të ndryshme nga kategorizimi akrobatik;

9. “Vendi kryesor i biznesit” nënkupton selinë kryesore ose zyrën e regjistrimit të një operatori të një planeri brenda së cilës ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operativ i aktiviteteve të referuara në këtë Rregullore;

10. “Marrëveshja e qirasë së thatë” nënkupton një marrëveshje midis sipërmarrjeve, sipas së cilës një planer operohet nën përgjegjësinë e qiramarrësit;

11. “Licencë kombëtare” nënkupton një licencë piloti e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në përputhje me legjislacionin kombëtar përpara datës së zbatimit të aneksit III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje ose të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 262, datë 28.6.2019, “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”;

12. “Licenca e pjesës-SFCL” nënkupton një licencë të ekuipazhit të fluturimit që përputhet me kërkesat e aneksit III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje;

13. “Raport konvertimi” nënkupton një raport mbi bazën e të cilit një licencë mund të konvertohet në një licencë sipas pjesës-SFCL.

Neni 3

Operimet ajrore

1. Operatorët e planerave duhet të operojnë planerat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin II.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për organizatat e projektimit ose të prodhimit, të cilat janë në përputhje me nenet 7 dhe 8, respektivisht, të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit” dhe që operojnë planera, brenda fushëveprimit të privilegjeve të tyre, për qëllimet e futjes ose modifikimit të llojeve të planerave.

2. Në përputhje me shkronjën (a) të nenit 30(1) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, operatorët e planerave mund të marrin pjesë në operimet tregtare ajrore, vetëm pasi të kenë deklaruar tek Autoriteti i Aviacionit Civil kapacitetin dhe mjetet e tyre për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me operimin e planerit.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet në operimet me planera si në vijim:

a) Operimet me kosto të ndara, me kusht që kostot direkte të fluturimit të planerit dhe një pjesë proporcionale e kostove vjetore të bëra për ruajtjen/magazinimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e planerit mbulohen nga personat në bord;

b) Fluturimet garuese ose shfaqjet fluturuese, me kusht që shpërblimi/pagesa ose çdo përfitim tjetër me vlerë për këto lloj fluturimesh kufizohet në mbulimin e kostove direkte të fluturimit të planerit dhe të një pjesë proporcionale të kostove vjetore të bëra për ruajtjen/magazinimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e planerit dhe se çdo çmim i përfituar të mos tejkalojë vlerën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

c) Fluturimet e prezantimit, fluturime për qëllime të hedhjeve me parashutë, tërheqjes së planerit ose fluturimeve akrobatoike të kryera ose nga një organizatë trajnimit që ka vendin e saj kryesor të aktivitetit në Republikën e Shqipërisë dhe referuar në nenin 8a të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje

me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose nga një organizatë e krijuar me qëllimin e promovimit të sportit ajror ose aviacionit argëtues, me kusht që organizata të operojë planerin mbi bazën e pronësisë ose të një marrëveshjeje të qirasë së thatë, që fluturimi nuk krijon fitime të cilat shpërndahen jashtë organizatës dhe që këto fluturime përfaqësojnë vetëm një pjesë të aktivitetit të organizatës;

d) Fluturimet e stërvitjes/trajnimit, të kryera nga një organizatë trajnuese që ka vendin e saj kryesor të biznesit në Republikën e Shqipërisë dhe të referuar në nenin 8a të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

Neni 3a

Licenca e pilotit dhe certifikimi mjekësor

1. Pa cenuar parashikimet e kësaj Rregulloreje, në lidhje me licencat e pilotëve të planerave, pilotët e avionëve të përmendur në nenin 1(1) të kësaj rregulloreje duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përcaktuara në aneksin III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje dhe në aneksin IV (pjesa-MED) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

2. Si përjashtim nga privilegjet e mbajtësve të licencave të përcaktuar në aneksin III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje, mbajtësit e këtyre licencave mund të kryejnë fluturimet e përmendura në shkronjat (a) deri në (d) të nenit 3(2) pa respektuar pikën SFCL.115(a)(3) të aneksit III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të autorizojë pilotët studentë që ndjekin një kurs trajnimi për licencën e pilotit me planera (“SPL”) për të ushtruar privilegje të kufizuara të pa supervizuar përpara se të plotësojnë të gjitha kërkesat që janë të nevojshme për lëshimin e një SPL-je, në përputhje me aneksin III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje, duke iu nënshtruar të gjitha kushteve të mëposhtme:

a) Fushëveprimi i privilegjeve të dhëna bazohet në një vlerësim të riskut të sigurisë në operim të kryer nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duke marrë parasysh shtrirjen e trajnimit të nevojshëm për arritjen e nivelit të synuar të kompetencës së pilotit;

b) Privilegjet do të kufizohen në sa vijon:

- i. të gjithë ose një pjesë të territorit kombëtar të Republikës së Shqipërisë, si shteti autorizues; dhe
- ii. planerat që janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, si shteti autorizues;

c) Mbajtësi i një autorizimi që aplikon për lëshimin e një SPL-je do të marrë kredite për trajnimin e kryer në bazë të një rekomandimi nga një organizatë trajnimi e miratuar (“ATO”) ose një organizatë e deklaruar trajnimi (“DTO”);

d) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur të jetë e zbatueshme duhet t’i dorëzojë raporte dhe vlerësime të riskut të sigurisë në operim Komisionit dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë në Operim të Aviacionit (“EASA”) çdo 3 vjet;

e) Autoriteti i Aviacionit Civil, duhet të monitorojë përdorimin e autorizimeve të lëshuara, sipas këtij paragrafi për të siguruar një nivel të pranueshëm të sigurisë së aviacionit dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura në rast të identifikimit të një rreziku të shtuar të sigurisë në operim ose ndonjë shqetësimi të sigurisë në operim.

Neni 3b

Kreditimi për trajnimin që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje

1. Në lidhje me lëshimin e licencave të pjesës SFCL dhe privilegjeve, kategorizimeve ose certifikatave shoqëruese në përputhje me aneksin III (pjesa-SFCL) të kësaj Rregulloreje, trajnimi që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje, në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, do të konsiderohet se është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

2. Trajnimi që ka filluar përpara datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje ose të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, do të kreditohet për qëllimet e lëshimit të licencave të pjesës-SFCL në bazë të një raporti kreditimi të krijuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në konsultim me EASA-n.

3. Raporti i kreditimit, i përmendur në paragrafin 2, do të përshkruajë qëllimin e trajnimit, do të tregojë se për cilat kërkesa është dhënë kreditimi sipas pjesës-SFCL dhe, nëse është e aplikueshme, cilat kërkesa duhet të përmbushin aplikantët për t’u pajisur me një licencë Part-SFCL. Ai do të përfshijë kopje të të gjitha dokumenteve të nevojshme për të vërtetuar qëllimin e trajnimit, si dhe kopje të rregulloreve dhe procedurave kombëtare në përputhje me të cilat trajnimi ka filluar.

Neni 3c

Organizatat e trajnimit

1. Organizatat e trajnimit për marrjen e licencave të pilotit të përmendura në nenin 1(1) të kësaj rregulloreje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 8a të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

2. Organizatat e trajnimit të përmendura në paragrafin 1, të cilat kanë një miratim të lëshuar në përputhje me aneksin VII (pjesa-ORA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose kanë dorëzuar një deklaratë në përputhje me aneksin VIII (pjesa-DTO) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, para datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje do të përshtatin programet e tyre të trajnimit, kur është e nevojshme, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

ANEKSI I PËRKUFIZIMET [PJESA-DEF]

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme dhe përveçse kur termat përcaktohen ndryshe në këtë aneks, përkufizimet e nenit 2 të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, si dhe të pikës FCL.010 të aneksit I (pjesa-FCL) të kësaj Rregulloreje:

1. “Mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC)” nënkupton standardet jodetyruese të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të treguar mjetet për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Autoriteti i Aviacionit

Civil mund të pranojë AMC të miratuara nga Agjencia për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, që përaftron Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2. “Mjetet alternative të përputhshmërisë (AltMoC)” nënkupton ato mjete që propozojnë një alternativë për një AMC ekzistuese ose ato që propozojnë mjete të reja për të vendosur përputhshmëri me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për të cilat nuk ka pasur AMC shoqëruese që të jenë miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3. “Pilot në komandë (PIC)” nënkupton një pilot të caktuar që është në komandë dhe i ngarkuar për kryerjen e sigurt të fluturimit;

4. “Manuali i fluturimit të avionit (AFM)” nënkupton një dokument që përmban kufizimet e operimeve të aplikueshme të miratuara dhe informacionin sipas planerit përkatës;

5. “Substanca psikoaktive” nënkupton alkoolin, opioidet, kanabinoidet, sedativët, hipnotikët, kokainën, psikosimulantët e tjerë, halucinogjenët dhe tretësit e paqëndrueshëm, me përjashtim të kafeinës dhe duhanit;

6. “Fazat kritike të fluturimit” nënkupton vrapimi në ngritje (vrulli i ngritjes), trajektorja e fluturimit në ngritje, afrimi final, afrimi i munguar, ulja, përfshirë rulimin/rrotullimin pas uljes dhe çdo fazë tjetër të fluturimit që piloti në komandë e përcakton si kritike për operimin e sigurt të planerit;

7. “Vend operimi” nënkupton një vend, i ndryshëm nga një aerodrom, i përzgjedhur nga piloti në komandë ose nga operatori për ulje ose ngritje;

8. “Anëtar ekuipazhi” nënkupton një person të caktuar nga një operator për të kryer detyrat në bordin e planerit, kur nuk është pilot në komandë, nën autoritetin e pilotit në komandë;

9. “Çanta elektronike e fluturimit (EFB)” nënkupton një sistem informacioni elektronik, i përbërë nga pajisjet dhe aplikacionet për ekuipazhin e fluturimit, që lejon ruajtjen, përditësimin, shfaqjen dhe përpunimin e funksioneve EFB për të mbështetur operimet ose detyrat e fluturimit;

10. “Mallra të rrezikshme” nënkupton artikuj ose substancat të cilat janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë në operim, pronën ose mjedisin dhe të cilat janë paraqitur në listën e mallrave të rrezikshme në udhëzimet teknike ose që klasifikohen sipas këtyre udhëzimeve;

11. “Udhëzime teknike” nënkupton botimin e fundit në fuqi të “Udhëzimeve teknike për transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme nga ajri”, duke përfshirë shtesat dhe ndryshimet e mundshme, të publikuara nga ICAO në dokumentin 9284-AN/905;

12. “Operime të specializuara me planer” nënkupton çdo lloj operimi, i cili mund të jetë tregtar ose jotregtar, me një planer ku qëllimi kryesor i të cilit nuk është i lidhur me veprimtari tipike sportive dhe rekreative, por me operime parashutiste, fluturimet mediatike, televizive ose filmike, shfaqje fluturimi ose aktivitete të ngjashme të specializuara;

13. “Natë” nënkupton periudhën midis mbarimit të muzgut në mbrëmje (sapo ka përfunduar perëndimi) dhe fillimit të agimit (para lindjes së diellit). Muzgu përfundon në mbrëmje kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë poshtë horizontit dhe fillon në mëngjes kur qendra e diskut të diellit është 6 gradë poshtë horizontit;

14. “Testi i aftësisë” nënkupton demonstrimin e aftësive me qëllim të lëshimit të një licence ose kategorizimi, ose zgjerimi të një privilegji, duke përfshirë provimet me gojë siç mund të kërkohej;

15. “Vlerësimi i kompetencës” nënkupton demonstrimin e aftësive, njohurive dhe qëndrimit për lëshimin fillestar, rivlerësimin ose rinovimin e një certifikate të instruktorit ose ekzaminuesit;

16. “Koha e fluturimit” nënkupton:

a) për planerat me vetë ngritje dhe TMG, koha totale nga momenti kur një avion fillon të lëvizë me qëllim ngritjen deri në momentin që ai ndalon përfundimisht në fund të fluturimit;

b) për planerat, koha totale që nga momenti kur avioni fillon lëvizjen në tokë në procesin e ngritjes deri në momentin kur planeri ndalon përfundimisht në fund të fluturimit;

17. “Kontroll i aftësisë” nënkupton demonstrimin e aftësive me qëllim të përmbushjes së kërkesave të fundit të përcaktuara në këtë rregullore, dhe duke përfshirë provimet me gojë siç mund të kërkohej;

18. “Fluturim i vetëm” nënkupton një fluturim gjatë të cilit një student pilot është pasagjeri i vetëm i një avioni;

19. “Fluturim përtej vendit (*crosscountry*)” nënkupton një fluturim jashtë vijës së shikimit ose distancës së përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil nga fusha e nisjes duke përdorur procedura standarde të lundrimit.

ANEKSI II OPERIMET AJRORE TË PLANERAVE [PJESA-SAO]

NËNPJESA GEN KËRKESAT E PËRGJITHSHME

SAO.GEN.100 Fushëveprimi

Në përputhje me nenin 3, kjo nënpjesë përcakton kërkesat që duhet të plotësohen nga çdo operator planerash, të ndryshëm nga organizatat e projektimit ose prodhimit të përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 3(1).

SAO.GEN.105 Autoriteti kompetent

Për rastet kur operatori ka vendin e tij kryesor të biznesit në Republikën e Shqipërisë, ose kur operatori nuk ka vend kryesor të biznesit, por është vendosur ose ka qendrën e banimit në Republikën e Shqipërisë, autoritet kompetent do të jetë Autoriteti i Aviacionit Civil. Ky autoritet do t’i nënshtrohet kërkesave të nenit 3 të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, në përputhje me nenin 1(7) të tij.

SAO.GEN.110 Demonstrimi i përputhshmërisë

a) Kur kërkohej nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili verifikon përputhshmërinë e vazhdueshme nga operatori në përputhje me pikën ARO.GEN.300(a)(2) të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, operatori demonstroi përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

b) Për të demonstruar një përputhshmëri të tillë, operatori mund t’u referohet mjeteve të mëposhtme:

- 1) mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC);
- 2) mjetet alternative të përputhshmërisë (AltMoC).

SAO.GEN.115 Fluturimet e prezantimit

Fluturimet e prezantimit duhet të:

- a) operohen sipas rregullave të fluturimit vizual (VFR) gjatë ditës; dhe
- b) mbikëqyren për sa i përket sigurisë në operim nga një person i cili është caktuar nga organizata përgjegjëse për fluturimet e prezantimit.

SAO.GEN.120 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi të sigurisë në operim

Operatori zbaton:

a) Masat e sigurisë në operim të përcaktuara/autorizuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me shkronjën (c) të pikës ARO.GEN.135 të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”; dhe

b) Direktivat e vlefshmërisë ajrore dhe informacionet e tjera të detyrueshme, në përputhje me shkronjën (h) të nenit 77(1) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

SAO.GEN.125 Caktimi i pilotit në komandë

Operatori duhet të caktojë një pilot në komandë i cili është i kualifikuar të veprojë si një pilot në komandë në përputhje me aneksin III të kësaj Rregulloreje.

SAO.GEN.130 Përgjegjësitë e pilotit në komandë

Piloti në komandë duhet:

a) Të jetë përgjegjës për sigurinë në operim të planerit dhe të çdo personi në bord gjatë operimeve të planerit;

b) Të jetë përgjegjës për fillimin, vazhdimin ose përfundimin e një fluturimi në interes të sigurisë në operim;

c) Të sigurojë që të gjitha procedurat operacionale të zbatueshme dhe listat e kontrolleve të jenë në përputhje me fluturimin/operimin;

d) Të fillojë fluturimin vetëm nëse ai/a jo bindet se të gjitha kërkesat operacionale janë përmbushur si më poshtë:

1) planeri ka status të vlefshmërisë ajrore;

2) planeri është i regjistruar në mënyrë të rregullt;

3) instrumentet dhe pajisjet e kërkuara për kryerjen e fluturimit mbahen në bordin e planerit dhe janë operative;

4) masa e planerit dhe vendndodhja e qendrës së gravitetit janë të tilla që fluturimi mund të kryhet brenda kufijve të përcaktuar në manualin e fluturimit të avionit (AFM);

5) të gjitha pajisjet dhe bagazhet janë të ngarkuara dhe të siguruara siç duhet dhe ekziston mundësia e një evakuimi emergjent; dhe

6) të mos tejkalojë në asnjë rast gjatë gjithë kohës së fluturimit, kufizimet/limitet e operimit të planerit, siç specifikohet në AFM;

e) Të sigurohet se inspektimi para fluturimit është kryer siç specifikohet në AFM;

f) Nuk duhet të kryejë detyra në një planer në një nga situatat e mëposhtme:

1) kur ai/a jo është i/e paaftë të kryejë detyrat për çdo lloj shkaku, duke përfshirë lëndimet, sëmundjet, ilaçet, lodhjen ose efektet e çdo substance psikoaktive, ose e ndjen veten si të papërshtatshëm;

2) nëse nuk plotësohen kërkesat mjekësore të zbatueshme;

g) Të refuzojë transportimin ose zbritjen e çdo personi ose bagazhi që mund të paraqesë një rrezik potencial për sigurinë në operim të planerit ose të çdo personi të transportuar në të;

h) Të mos lejojë hipjen në planer të asnjë personi që dyshohet se është nën ndikimin e substancave psikoaktive, në atë masë që mund të cenojë sigurinë e operimit të planerit dhe të personave në bord;

i) Të sigurojë që gjatë fazave kritike të fluturimit ose aty ku gjykohej si e nevojshme në interes të sigurisë në operim, të gjithë personat në bord të jenë të ulur dhe të kenë rripat e tyre të sigurimit të lidhur;

j) Gjatë fluturimit:

1. të mbajë rripin e tij të sigurisë të lidhur; dhe

2. të qëndrojë në kontroll të planerit në çdo moment, përveç rastit kur kontrollin e planerit e merr një pilot tjetër;

k) Të ndërmarre çdo veprim në një situatë emergjente që kërkon një vendim dhe veprim të menjëhershëm të cilin ai/ajo e konsideron të nevojshëm për situatën; në raste të tilla, ai/ajo mund të devijojë nga rregullat, procedurat operacionale dhe metodat, në masën e nevojshme në interes të sigurisë në operim;

l) Nuk duhet të vazhdojë fluturimin përtej aerodromit më të afërt me mot të lejuar ose vendit të operimit, kur kapaciteti/aftësia e tij/saj për të kryer detyrat zvogëlohet ndjeshëm, për shkak të sëmundjes, lodhjes ose mungesës së oksigjenit ose të çfarëdo arsyeje tjetër;

m) Regjistrojë çdo të dhënë të nevojshme dhe të gjitha defektet e njohura ose të dyshuara në planer në përfundim të fluturimit, ose serive të fluturimeve, në regjistrin teknik të avionit ose në regjistrin ditor të udhëtimit;

n) Të njoftojë autoritetin shtetëror të investigimit të sigurisë në operim në territorin e të cilit ka ndodhur ngjarja dhe shërbimet e emergjencës së atij Shteti pa vonesë me mjetet më të shpejta të mundshme për çdo aksident ose incident serioz që i ka ndodhur planerit në fjalë;

o) Të dorëzojë një raport të çdo akti të ndërhyrjes së paligjshme pa vonesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil dhe të informojë autoritetin lokal të përcaktuar nga Shteti në territorin e të cilit ndodhi ndërhyrja e paligjshme; dhe

p) Të raportojë te njësia e duhur e shërbimeve të trafikut ajror (ATS), pa vonesë, çdo kusht të rrezikshëm të motit ose të fluturimit që haset i cili mund të ndikojë në sigurinë në operim të avionëve të tjerë.

SAO.GEN.135 Përgjegjësitë e anëtarëve të ekuipazhit

a) Çdo anëtar i ekuipazhit do të jetë përgjegjës për kryerjen e duhur të detyrave të tij/saj, në lidhje me operimin e planerit.

b) Asnjë anëtar i ekuipazhit nuk do të kryejë detyrat në një planer kur është i paaftë për çdo lloj shkak, duke përfshirë lëndimet, sëmundjet, ilaçet, lodhjen ose efektet e çdo substance psikoaktive, ose nëse e ndjen veten si të papërshtatshëm.

c) Çdo anëtar i ekuipazhit do t'i raportojë pilotit në komandë për dy gjërat në vijim:

1. çdo avari, dështim, mosfunksionim, keqfunksionim ose defekt, për të cilin ai ose ajo beson se mund të ndikojë në vlefshmërinë ajrore ose në operimin e sigurt të planerit, duke përfshirë sistemet e emergjencës;

2. çdo incident.

SAO.GEN.140 Përputhshmëria me ligjet, rregulloret dhe procedurat

a) Piloti në komandë dhe çdo anëtar tjetër i ekuipazhit duhet të veprojnë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e atyre shteteve ku kryhen operimet.

b) Piloti në komandë duhet të jetë i familjarizuar me ligjet, rregulloret dhe procedurat, që lidhen me kryerjen e detyrave të tij ose të saj, të përshkruara për zonat ku do të kalohet, aerodromet ose vendet e operimit që do të përdoren dhe facilitetet/strukturat e përkatëse të navigimit ajror.

SAO.GEN.145 Pajisjet elektronike portative

Piloti në komandë nuk do të lejojë asnjë person të përdorë një pajisje elektronike portative (PED) në bordin e planerit, duke përfshirë këtu çantën elektronike të fluturimit (EFB), që mund të ndikojë negativisht në performancën e sistemeve dhe pajisjeve të planerit ose aftësinë për ta operuar atë.

SAO.GEN.150 Mallrat e rrezikshme

a) Piloti në komandë nuk do të lejojë asnjë person të mbajë mallra të rrezikshme në bord.

b) Sasitë e arsyeshme të artikujve dhe substancave të cilat përndryshe do të klasifikoheshin si mallra të rrezikshme dhe që përdoren për të facilituar sigurinë në operim, kur transportimi i tyre në bordin e planerit është i këshillueshëm që të sigurohet disponueshmëria e tyre në kohë e për qëllime operimi, duhet të konsiderohen si të autorizuar.

SAO.GEN.155 Dokumentet, manualët dhe informacioni që do të mbahen

a) Të gjitha dokumentet e mëposhtme, manualët dhe informacioni do të mbahen në çdo fluturim si origjinalet ose kopjet:

- 1) AFM, ose dokumenti/at ekuivalent/e;
- 2) detajet e planit të fluturimit ATS të plotësuar, kur kërkohet në përputhje me seksionin 4 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operationale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, të ndryshuar;
- 3) hartat aeronautike aktuale dhe të përshtatshme për zonën e fluturimit të parashikuar/synuar;
- 4) çdo dokumentacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm për fluturimin ose që kërkohet nga Shtetet e përfshira në fluturim;
- 5) procedurat dhe informacioni mbi sinjalet vizuale për përdorimin e avionëve përgjues dhe të përgjuar;

b) Gjithashtu, kur kërkohet një deklaratë në përputhje me pikën SAO.DEC.100, një kopje e deklaratës duhet të merret në çdo fluturim;

c) Kur nuk mbahen në bord, të gjitha dokumentet e mëposhtme, manualët dhe informacioni duhet të mbeten të disponueshëm në aerodrome ose në vendin e operimit si origjinalet ose kopjet:

- 1) certifikata e regjistrimit;
- 2) certifikata e vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë anekset;
- 3) certifikata e rishikimit e vlefshmërisë ajrore;
- 4) certifikata e zhurmave, nëse certifikata e zhurmave ka qenë e lëshuar për një planer me motor;
- 5) licenca e radios së avionit, kur planeri është i pajisur me pajisje radiokomunikimi në përputhje me pikën SAO.IDE.130;

6) certifikata/t e sigurimit të përgjegjësisë për palët e treta;

7) regjistri ditor i udhëtimit ose ekuivalenti i tij;

d) Me përjashtim të shkronjave (a) dhe (b), dokumentet, manualët dhe informacioni i specifikuar këtu mund të mbahen në aerodrome ose në vendin e operimit për fluturimet:

- 1) që synohet të mbeten brenda sferës së aerodromit ose vendit të operimit; ose
- 2) duke qëndruar brenda një distance ose zone të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

e) Kur kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, piloti në komandë ose operatori, duhet t'i vërë në dispozicion këtij autoriteti dokumentet origjinale në periudhën kohore të specifikuar nga autoriteti e cila nuk duhet të jetë më pak se 24 orë.

SAO.GEN.160 Regjistri ditor të udhëtimit

Për çdo fluturim, ose seri fluturimesh, detajet/hollësitë e planerave, të ekuipazhit të tyre dhe të çdo udhëtimi duhet të regjistrohen në formën e një regjistri ditor udhëtimi ose dokumenti ekuivalent.

NËNPJESA OP PROCEDURAT E OPERIMIT

SAO.OP.100 Përdorimi i aerodromeve dhe vendeve të operimit

Piloti në komandë duhet të përdorë vetëm aerodromet ose vendet e operimit që janë të përshtatshme për tipin e planerit dhe operimit që do të kryhet.

SAO.OP.105 Procedurat e zvogëlimit të zhurmës – planera me motor

Piloti në komandë duhet të ketë parasysh procedurat e operimit për të zvogëluar/minimizuar efektin e zhurmës së motorit të planerit, duke garantuar ndërkohë që siguria në operim të ketë përparësi ndaj zvogëlimit të zhurmës.

SAO.OP.110 Informimi i pasagjerëve

Piloti në komandë duhet të sigurojë që para dhe, kur është e përshtatshme, gjatë fluturimit, pasagjeri informohet për procedurat normale, anormale dhe ato të emergjencës.

SAO.OP.115 Transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve

Piloti në komandë duhet të sigurojë që personat që kërkojnë kushte, asistencë ose pajisje të veçanta, kur hipin në bordin e planerit, transportohen sipas kushteve që garantojnë sigurinë në operim të planerit dhe të çdo personi ose objekti pronësie që transportohet aty nga ata.

SAO.OP.120 Përgatitja për fluturim

Para fillimit të fluturimit, piloti në komandë duhet të sigurohet për të gjitha si më poshtë:

a) Kushtet e kërkuara për operim të sigurt të planerit janë të përshtatshme për tipin e operimit sipas të cilit do të kryhet fluturimi;

b) Që kushtet meteorologjike do të lejojnë që fluturimi të përfundojë në mënyrë të sigurt;

c) Në rastin e planerit me motor dhe kur mendohet të përdoret motori, sasia e karburantit ose energjisë tjetër është e mjaftueshme për të lejuar që fluturimi të përfundojë në mënyrë të sigurt.

SAO.OP.125 Rifurnizimi (me karburant) dhe rikarikimi ose zëvendësimi i baterive, me persona në bord – planerat me motor

Kur një pasagjer është në bordin e një planeri me motor:

a) Planeri nuk duhet të furnizohet me karburant; dhe

b) Bateritë e përdorura si fuqi shtytëse nuk duhet të rikarikohen ose të zëvendësohen.

SAO.OP.130 Pirja e duhanit në bord

Asnjë person nuk duhet të pijë duhan në bordin e planerit gjatë asnjë faze të fluturimit.

SAO.OP.135 Kushtet meteorologjike

Piloti në komandë duhet të fillojë ose vazhdojë fluturimin vetëm nëse informacionet meteorologjike të kohëve të fundit të disponueshme, tregojnë se është i disponueshëm një opsion uljeje e sigurt.

SAO.OP.140 Akulli dhe ndotësit e tjerë – procedurat në tokë

Piloti në komandë duhet të fillojë fluturimin vetëm nëse planeri është i pastër nga çdo papastërti që mund të ndikojë negativisht në performancën ose kontrollueshmërinë e planerit, përveç kur lejohet në AFM.

SAO.OP.145 Rifurnizimi në ajër me karburant ose menaxhime të tjera energjie – planerat me motor

Për planerat me motor, piloti në komandë duhet të kontrollojë në intervale të rregullta gjatë fluturimit që sasia e karburantit të përdorshëm ose energjia tjetër e disponueshme, nuk është më e vogël se ajo e nevojshme për të siguruar uljen e sigurt.

SAO.OP.150 Përdorimi i oksigjenit shtesë

Piloti në komandë duhet të sigurojë që të gjithë personat në bord të përdorin oksigjen shtesë kurdoherë që ai ose ajo përcakton se, në lartësinë e fluturimit që do të kryhet, mungesa e oksigjenit mund të shkaktojë një reduktim të aftësive të tyre ose të sjellë efekte dëmtuese mbi ta.

SAO.OP.155 Operimet e specializuara të planerit

a) Para fillimit të operimeve të specializuara të planerit ose serive të tyre, piloti në komandë duhet të kryejë një vlerësim të riskut, duke vlerësuar kompleksitetin e aktivitetit me qëllim të përcaktimit të rreziqeve dhe risqeve të lidhura me operimin që synohet të kryhet dhe të përcaktojë masa zbutëse/lehtësuese kur është e nevojshme.

b) Një operim i specializuar i planerit duhet të kryhet në përputhje me një listë kontrolli. Piloti në komandë duhet të përcaktojë atë listë kontrolli dhe të sigurohet që është e përshtatshme për aktivitetin e specializuar dhe për përdorimin e planerit, bazuar në vlerësimin e riskut dhe duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë aneks. Lista e kontrollit duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme në

çdo fluturim për pilotin në komandë dhe për çdo anëtar tjetër të ekuipazhit, aty ku është e nevojshme/rëndësishme për kryerjen e detyrave të tyre.

c) Piloti në komandë duhet që rregullisht të rishikojë dhe përditësojë listën e kontrollit aty ku është e nevojshme me qëllim që të llogarisë në kohë vlerësimin e riskut.

NËNPJESA POL PERFORMANCA DHE KUFIZIMET E OPERIMIT

SAO.POL.100 Peshimi

a) Peshimi i planerit duhet të kryhet nga prodhuesi i planerit ose në përputhje me aneksin I të urdhrorit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, “Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”.

b) Operatori duhet të sigurojë që masa e planerit është përcaktuar përmes peshimit aktual/efektiv para hyrjes së tij fillestare në shërbim. Efektet e grumbulluara të modifikimeve dhe riparimeve në masë, do të kontabilizohen/justifikohen dhe dokumentohen siç duhet. Ky informacion duhet t’i vihet në dispozicion pilotit në komandë. Planeri duhet të ripeshohet nëse efektet e modifikimeve ose riparimeve në masë nuk janë të njohura.

SAO.POL.105 Performanca – e përgjithshme

Piloti në komandë duhet ta operojë planerin vetëm nëse performanca e planerit është e përshtatshme për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në aneksin e urdhrorit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, të ndryshuar, dhe çdo kufizim tjetër të zbatueshëm për fluturimin, hapësirën ajrore, aerodromet ose vendet e operimeve të përdorura, duke siguruar që çdo grafik ose hartë e përdorur është version i botimit të fundit në dispozicion.

NËNPJESA IDE INSTRUMENTET, TË DHËNAT DHE PAJISJET

SAO.IDE.100 Instrumentet dhe pajisjet – të përgjithshme

a) Instrumentet dhe pajisjet e kërkuara nga kjo nënpjesë duhet të miratohen në përputhje me aneksin I të urdhrorit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, ose, kur të regjistrohen në një vend tjetër, me kërkesat e vlefshmërisë ajrore të shtetit të regjistrorit, nëse një nga kushtet e mëposhtme plotësohet:

- 1) ato përdoren nga ekuipazhi i fluturimit për kontrollin e trajektores/rrugëtimit të fluturimit;
- 2) ato përdoren në përputhshmëri me pikat SAO.IDE.130 OSE SAO.IDE.135;
- 3) ato janë instaluar përfundimisht në planer;

b) Me përjashtim të shkronjës (a), të gjitha instrumentet ose pajisjet e mëposhtme, kur kërkohet nga kjo nënpjesë, nuk kanë nevojë për aprovim:

- 1) dritat e lëvizshme/portative të pavarura;
- 2) një kohëmatës i saktë;
- 3) pajisjet e mbijetesës dhe sinjalizimit;

c) Instrumentet dhe pajisjet duhet të jenë lehtësisht të disponueshme dhe operueshme nga vendi i punës ku është ulur piloti në komandë ose një nga anëtarët e ekuipazhit, i cili ka nevojë t’i përdorë ato.

SAO.IDE.105 Instrumentet e fluturimit dhe navigimit

a) Planerat duhet të jenë të pajisura me një mjet matës dhe që tregon të gjitha si më poshtë:

- 1) kohën në orë dhe minuta;
- 2) presionin sipas lartësisë;
- 3) treguesin e shpejtësisë;
- 4) në rastin e planerave me motor, drejtimin magnetik.

b) Përveç shkronjës (a), kur operohet në kushte ku planeri nuk mund të qëndrojë në trajektoren e dëshiruar të fluturimit, pa iu referuar një ose më shumë instrumenteve shtesë, kur kryhen fluturime në re, ose kur operohet natën, planerat duhet të pajisen me mjete që matin dhe tregojnë të gjitha si më poshtë:

- 1) shpejtësinë vertikale;
- 2) pozicionin/qëndrimin ose kthesat dhe rrëshqitjen;
- 3) drejtimin magnetik.

SAO.IDE.110 Dritat e operimit

Planerat që operojnë gjatë natës duhet të pajisen me të gjitha si më poshtë:

- a) Një sistem dritash kundër përplasjeve në ajër;
- b) Dritat e navigimit/pozicionit;
- c) Dritat e uljes;
- d) Ndriçimin me ushqyes/i furnizuar nga sistemi elektrik i planerit për të siguruar ndriçimin e duhur për të gjitha instrumentet dhe pajisjet e domosdoshme për operim të sigurt të planerit;
- e) Një dritë të pavarur të lëvizshme për pilotin në komandë dhe për cilindo anëtar të ekuipazhit në vendin e tij të punës.

SAO.IDE.115 Oksigjeni shtesë

Planerat e përdorur, kur kërkohet një furnizim me oksigjen në përputhje me pikën SAO.OP.150, duhet të pajisen me mjete për ruajtjen e oksigjenit dhe aparate shpërndarjeje që janë në gjendje të ruajnë dhe shpërndajnë furnizimet e nevojshme të oksigjenit.

SAO.IDE.120 Pajisjet e shpëtimit dhe sinjalizimit – fluturimet mbi ujë

Piloti në komandë i një planeri që operohet mbi ujë duhet të përcaktojë, para fillimit të fluturimit, rreziqet që mund të cenojnë mbijetesën e çdo personi të transportuar në planer në rastin e uljes së detyrues në ujë. Në kuadrin e këtyre rreziqeve, ai ose ajo duhet të përcaktojë kur dhe ku është e nevojshme të merren/transportohen pajisjet e shpëtimit dhe ato sinjalizuese.

SAO.IDE.125 Pajisjet e shpëtimit dhe sinjalizimit – vështirësitë e kërkimit – shpëtimit

Planerat e operuar mbi zonat ku kërkimi dhe shpëtimi (SAR) do të ishte veçanërisht i vështirë, duhet të pajisen me pajisje të tilla të shpëtimit dhe sinjalizimit të përshtatshme për zonën mbi të cilën fluturohet.

SAO.IDE.130 Pajisjet e radiokomunikimit

Planerat duhet të kenë pajisje të radiokomunikimit për të lejuar komunikimin e kërkuar në përputhje me shtojcën 4 të aneksit të urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, të ndryshuar dhe, nëse fluturimi zhvillohet në hapësirën ajrore të një vendi tjetër, në përputhje me ligjin e atij vendi tjetër.

SAO.IDE.135 Transponderi

Planerat duhet të kenë një transponder radar të survejimit sekondar (SSR) me të gjitha aftësitë e kërkuara në përputhje me shkronjën (b) të pikës SERA.6005 të aneksit urdhrit të ministrit nr. 42, datë 27.3.2023, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale, në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, të ndryshuar, dhe nëse fluturimet kryhen në hapësirën ajrore të një vendi tjetër, ligjin e atij vendi tjetër.

NËNPJESA DEC DEKLARATA

SAO.DEC.100 Deklarata

a) Në deklaratën e referuar në nenin 3(2), operatori duhet të konfirmojë që ai përputhet dhe do të vazhdojë të jetë, në përputhje me kërkesat thelbësore të vendosura në shtojcën V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

b) Operatori duhet të përfshijë në deklaratë të gjithë informacionet e mëposhtme:

1) emrin e operatorit;

2) vendin ku operatori ka vendin kryesor të biznesit;

3) detajet e kontaktit të operatorit;

4) ditën e fillimit të operimit dhe, kur është e nevojshme, datën në të cilën ndryshimi i një deklarate ekzistuese hyn në fuqi;

5) në lidhje me të gjithë planerat e përdorur për operime tregtare, tipin e planerit, regjistrimin, bazën kryesore, llojin e operimit dhe vazhdimësinë e menaxhimit të vlefshmërisë ajrore të organizatës;

c) Operatori, kur bën deklaratën, duhet t’ia njoftojë Autoritetit të Aviacionit Civil listën e AltMoC-së për të demonstruar përputhshmërinë kur një gjë e tillë kërkohet, në përputhje me pikën SAO.GEN.110. Kjo listë duhet të përmbajë referencat për AMC-të përkatëse;

d) Kur bën deklaratën, operatori duhet të përdorë formën që gjendet te shtojca e këtij aneksi.

SAO.DEC.105 Ndryshimet në deklaratë dhe ndërprerja e operimeve tregtare

a) Operatori duhet të njoftojë pa vonesë Autoritetin e Aviacionit Civil për çdo ndryshim në rrethanat që ndikojnë në përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje, siç janë deklaruar tek Autoriteti i Aviacionit Civil, për çdo ndryshim, në lidhje me informacionin e përmendur në pikën SAO.DEC.100(b) dhe listën e AltMoC-së të referuar në pikën SAO.DEC.100(c), siç përfshihet ose i bashkëngjitet deklaratës.

b) Operatori duhet të njoftojë pa vonesë Autoritetin e Aviacionit Civil se nuk është më i angazhuar në operimet tregtare me planer.

SHTOJCË

DEKLARATË				
Në përputhje me urdhrin e ministrit nr. ____, datë ____ që miraton rregulloren, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, ‘Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil’, i ndryshuar”				
Operatori				
Emri:				
Vendi ku operatori ka vendin kryesor të biznesit:				
Detajet e kontaktit:				
Operim me planer				
Data e fillimit të operimit tregtar dhe, kur është e nevojshme, data e ndryshimit të operimit tregtar ekzistues:				
Informacioni për planerin/at e përdorur, operim/e tregtar dhe menaxhimi i vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore ⁽¹⁾ :				
Tipi i planerit	Regjistrimi i planerit	Baza kryesore	Tipi/at i operimit ⁽²⁾	Organizata e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore ⁽²⁾

Aty ku është e aplikueshme, listën e AltMoC me referencat që shoqërojnë AMC (bashkëngjitur deklaratës):
Deklarimet
☐ Operatori ka përputhshmëri dhe do të vazhdojë të ketë përputhshmëri, me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e urdhrat të ministrit nr. __, datë ____, që miraton rregulloren, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat”.
Veçanërisht, operatori kryen operimet e tij tregtare, në përputhje me kërkesat në vazhdim të aneksit II të rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat”.
☐ Të gjithë planerat që operojnë kanë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore ⁽¹⁾ të lëshuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”.
☐ Çdo pilot që mban një licence dhe kualifikimet/kategorizimet e lëshuara ose të pranura në përputhje me aneksin I të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, siç kërkohet nga pika SAO.GEN.125 e aneksit II.
☐ Operatori duhet të njoftojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil çdo lloj ndryshimi në rrethanat që ndikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe me kërkesat e Rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e planerave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për planerat”, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar siç është deklaruar tek Autoriteti i Aviacionit Civil nëpërmjet kësaj deklarate dhe të çdo ndryshimi të informacionit dhe listave të AltMoC të përfshira brenda dhe bashkëlidhur kësaj deklarate, siç kërkohet nga pika SAO.DEC.100(c) e aneksit II.
☐ Operatori konfirmon që i gjithë informacioni i përfshirë në këtë deklaratë, përfshirë anekset e tij, është i plotë dhe korrekt/saktë.
Data, emri dhe nënshkrimi

(1) Plotëso tabelën. Nëse aty nuk ka hapësirën e duhur për të rreshtuar informacionin, duhet të bëhet në një shtojcë tjetër më vete.

Shtojcës duhet t'i vihet data dhe të nënshkruhet.

(2) “Tipat e operimit” i referohet tipit të operimeve tregtare të kryera me planer.

(3) Informacioni rreth organizatës përgjegjëse për menaxhimin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore duhet të përfshijë emrin e organizatës, adresën dhe referencën e aprovimit.

(4) Certifikata e vlefshmërisë ajrore është një certifikatë normale e vlefshmërisë ajrore, një certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore ose një leje për të fluturuar, e lëshuar në përputhje me kërkesat e aneksit I të urdhrat të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”.

ANEKSI III KËRKESAT PËR LICENCIMIN E EKUIPAZHIT TË FLUTURIMIT ME PLANERA [PART-SFCL]

NËNPJESA GEN KËRKESAT E PËRGJITHSHME

SFCL.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton kërkesat për lëshimin e licencës së pilotit të planerave (“SPL”) dhe privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat përkatëse, si dhe kushtet për vlefshmërinë dhe përdorimin e tyre.

SFCL.005 Autoriteti kompetent

Kur Republika e Shqipërisë është vendi në të cilin një person aplikon për lëshimin e një SPL-je ose privilegjeve, kategorizimeve ose certifikatave të lidhura me to, për qëllimin e këtij aneksi, autoriteti kompetent do të jetë Autoriteti i Aviacionit Civil.

SFCL.015 Aplikimi për lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e një SPL-je, si dhe privilegjeve, kategorizimeve dhe certifikatave të lidhura

a) Sa vijon duhet t'i dorëzohet Autoritetit të Aviacionit Civil në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ky autoritet:

1) një aplikim për:

i. lëshimin e një SPL-je dhe kategorizimeve përkatëse;

ii. zgjerimin e privilegjeve të një SPL-je, me përjashtim të privilegjeve të specifikuar në pikat SFCL.115(a)(2) dhe (a)(3), SFCL.155, SFCL.200 dhe SFCL.215;

iii. lëshimin e një certifikate instruktore të fluturimit për planerat (“FI(S)”);

iv) lëshimin, rivlerësimin dhe rinovimin e certifikatës së ekzaminuesit të fluturimit për planerat (“FE(S)”);

v) çdo ndryshim në SPL dhe privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat përkatëse, me përjashtim të privilegjeve të përmendura në pikën (ii); dhe

2) nëse kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një kopje të hyrjeve përkatëse të librit të fluturimit siç specifikohet në pikat SFCL.115(d), SFCL.155(b), SFCL.200(f) dhe SFCL.215(d);

b) Një aplikim siç specifikohet në paragrafin (a) duhet të shoqërohet me evidenca që aplikanti përmbush kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë aneks dhe në aneksin IV (pjesa-MED) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

c) Çdo kufizim ose zgjerim i privilegjeve të dhëna nga një licencë, klasifikim ose certifikatë do të miratohet në licencë ose certifikatë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, me përjashtim të marrjes së privilegjeve siç specifikohet në paragrafin (a) (1) (ii).

d) Një person nuk duhet të mbajë në asnjë moment më shumë se një SPL të lëshuar në përputhje me këtë aneks.

e) Një mbajtës i licencës duhet t’i paraqesë aplikimet siç specifikohet në paragrafin (a) tek Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili ka lëshuar ndonjë nga licencat e tij në përputhje me këtë aneks (pjesa-SFCL) ose aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, ose aneksin III (pjesa-BFCL) të urdhrit nr. 306, datë 6.12.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat” që përaftron Rregulloren e BE-së nr. 2018/395, sipas rastit;

f) Kur të jetë e zbatueshme, një mbajtës i një SPL-je mund të aplikojë për një ndryshim të autoritetit kompetent, pranë autoritetit kompetent i caktuar nga një shtet tjetër anëtar i BE-së, por në këtë rast autoriteti i ri kompetent duhet të jetë i njëjtë për të gjitha licencat e mbajtura.

Një mbajtës i një SPL-je të lëshuar nga një shtet anëtar i BE-së mund të aplikojë për një ndryshim të autoritetit kompetent, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, por në këtë rast autoriteti i ri kompetent duhet të jetë i njëjtë për të gjitha licencat e mbajtura.

g) Aplikantët do të aplikojnë për lëshimin e një SPL-je dhe kategorizimeve, privilegjeve ose certifikatave përkatëse, jo më vonë se gjashtë muaj pasi të kenë përfunduar me sukses testin e aftësive ose vlerësimin e kompetencës.

SFCL.030 Testi praktik i aftësive

Aplikantët për një test aftësie duhet të rekomandohen për testin e aftësisë nga ATO ose DTO që është përgjegjëse për trajnimin e ndërmarrë nga aplikantët, sapo trajnimi të ketë përfunduar. Të dhënat e trajnimit do t’i vihen në dispozicion ekzaminuesit nga ATO ose DTO.

SFCL.035 Kreditimi i kohës së fluturimit

Aplikantët për një SPL ose një privilegj, kategorizim ose certifikatë të shoqëruar do të kreditohen plotësisht me të gjitha orët e fluturimit në kohë fluturimi vetëm, instruksioni dyshe, ose kohën e fluturimit si PIC në planera, në lidhje me kërkesën për kohën totale të fluturimit për licencën, privilegjin, kategorizimin ose certifikatën.

SFCL.045 Detyrimi për të mbajtur dhe paraqitur dokumente

a) Kur ushtrojnë privilegjet e licencës SPL, mbajtësit e një SPL-je duhet të mbajnë me vete të gjitha sa vijon:

- 1) një SPL të vlefshme;
- 2) një certifikatë mjekësore të vlefshme;
- 3) një dokument identifikimi personal që mban fotografinë e tij;

4) të dhëna të mjaftueshme të librit të fluturimit (*logbook*) për të demonstruar përputhjen me kërkesat e këtij aneksi;

b) Pilotët studentë duhet të mbajnë me vete në të gjitha fluturimet solo të kryera përtej vendit:

1) dokumentet e specifikuara në paragrafët (a) (2) dhe (a) (3);

2) dëshmi të autorizimit të kërkuar nga pika SFCL.125(a);

c) Mbajtësit e një SPL-je ose pilotët studentë duhet të paraqesin pa vonesë të panevojshme dokumentet e specifikuara në shkronjën (a) për inspektim me kërkesë të një përfaqësuesi të autorizuar të Autoritetit të Aviacionit Civil.

d) Me përjashtim të shkronjave (a) dhe (b), dokumentet e specifikuara aty mund të mbahen në aerodrom ose në vendin e operimit për fluturimet që mbeten:

(1) brenda fushës së shikueshmërisë së aerodromit ose vendit të operimit; ose

2) brenda një largësie nga aerodromi ose vendi i operimit të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

SFCL.050 Regjistrimi i kohës së fluturimit

Mbajtësit e një SPL-je dhe pilotët studentë duhet të mbajnë një regjistër të besueshëm të detajeve të të gjitha fluturimeve të kryera në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

SFCL.065 Kufizimi i privilegjeve të mbajtësve të SPL-së të moshës 70 vjeç e lart në fluturimin tregtar me planera të pasagjerëve

Mbajtësit e SPL-së që kanë mbushur moshën 70 vjeç nuk do të veprojnë si pilotë të një planeri të angazhuar në operimet tregtare të planerave me pasagjerë.

SFCL.070 Kufizimi, pezullimi dhe revokimi i licencave, privilegjeve, kategorizimeve dhe certifikatave

a) Një SPL, si dhe privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat përkatëse të lëshuara, në përputhje me këtë aneks, mund të kufizohen, pezullohen ose revokohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në aneksin VI (pjesa-ARA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, nëse mbajtësi i një SPL-je nuk përputhet me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar ose me kërkesat e këtij aneksi si dhe të aneksit II (pjesa-SAO) të kësaj Rregulloreje ose me aneksin IV (pjesa-MED) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

b) Mbajtësit e SPL-së duhet t’ia kthejnë menjëherë licencën ose certifikatën Autoritetit të Aviacionit Civil nëse licenca, privilegji, kategorizimi ose certifikata e tyre është kufizuar, pezulluar ose revokuar.

NËNPJESA SPL

LICENCA E PILOTTIT TË PLANERIT (“SPL”)

SFCL.115 SPL – Privilegjet dhe kushtet

a) Me përjashtim të kërkesave të parashikuara në pikën SFCL.150, privilegjet e mbajtësve të SPL-së janë që të veprojnë si PIC në planera:

1) pa shpërblim në operime jo tregtare;

2) duke përfshirë transportin e pasagjerëve vetëm nëse ata:

i) përputhen me pikën SFCL.160(e); dhe

ii) ose:

A) kanë përfunduar, pas lëshimit të SPL-së, të paktën 10 orë kohë fluturimi ose 30 nisje ose ngritje dhe ulje si PIC në planera dhe, përveç kësaj, një fluturim trajnimi gjatë të cilit mbajtësit duhet t'i demonstrojnë një FI(S) kompetencën e kërkuar për transportin e pasagjerëve; ose

B) të mbajnë një certifikatë FI(S) në përputhje me nënpjesën FI;

3) në operime të ndryshme nga ato të specifikuara në paragrafin (1), vetëm nëse ata kanë:

i. mbushur moshën 18 vjeç;

ii. përfunduar, pas lëshimit të licencës, 75 orë kohë fluturimi ose 200 nisje/hedhje ose ngritje dhe ulje si PIC në planera.

b) Me përjashtim të shkronjës (a), mbajtësit e SPL-së që kanë privilegje instruktori ose ekzaminuesi mund të marrin shpërblim, për:

1) ofrimin e instruksioneve të fluturimit për SPL;

2) kryerjen e testeve të aftësive dhe kontroleve të aftësisë për SPL;

3) trajnimin, testimin dhe kontrollin për privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat e bashkangjitura me një SPL;

c) Mbajtësit e SPL-së ushtrojnë privilegjet e SPL-së vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përvojës së fundit dhe vetëm nëse certifikata e tyre mjekësore, e përshtatshme për privilegjet e ushtruara, është e vlefshme;

d) Përfundimi i trajnimit të fluturimit siç specifikohet në paragrafin (a)(2)(ii)(A) duhet të regjistrohet në librin e fluturimit të pilotit dhe të nënshkruhet nga instruktori që është përgjegjës për trajnimin e fluturimit

SFCL.120 SPL – Mosha minimale

Aplikantët për një SPL duhet të jenë të paktën 16 vjeç.

SFCL.125 SPL – Piloti student

a) Pilotët student nuk duhet të fluturojnë vetëm, përveç kur autorizohen për ta bërë këtë dhe mbikëqyrën nga një FI(S);

b) Piloti studentë duhet të jenë të paktën 14 vjeç për t'u lejuar në fluturime solo.

SFCL.130 SPL – Kërkesat për kursin e trajnimit dhe eksperiencën

a) Aplikantët për një SPL duhet të përfundojnë një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO. Kursi duhet të përshtatet me privilegjet e kërkuara dhe duhet të përfshijë:

1) njohuritë teorike siç specifikohet në pikën SFCL.135;

2) të paktën 15 orë instruksione fluturimi në planera, duke përfshirë të paktën:

i. 10 orë instruksione fluturimi dyshe, që duhet të përfshijë instruksionet e fluturimit dyshe, siç specifikohet në paragrafët (iv) (A) ose (v) (A), sipas rastit;

ii. dy orë kohë fluturimi të mbikëqyrur vetëm;

iii. 45 nisje ose ngritje dhe ulje;

iv. nëse kërkohen privilegjet për planerat, me përjashtim të TMG-ve, të paktën shtatë orë instruksione fluturimi në planera, duke përjashtuar TMG-të, dhe duke përfshirë të paktën:

A) tri orë instruksione fluturimi dyshe;

B) ose:

a) një fluturim i vetëm përtej vendit (*cross-country*) prej të paktën 50 km (27 NM); ose

b) një fluturim dyshe përtej vendit (*cross-country*) prej të paktën 100 km (55 NM), i cili, me përjashtim të paragrafit (2) (iv), mund të kryhet në një TMG;

v. nëse kërkohen privilegjet për TMG, të paktën gjashtë orë instruksione fluturimi në TMG, duke përfshirë të paktën:

A) katër orë instruksione fluturimi dyshe;

B) një fluturim i vetëm përtej vendit (*cross-country*) prej të paktën 150 km (80 NM) në një TMG, gjatë të cilit duhet të kryhet një ulje me ndalesë të plotë në një aerodrom të ndryshëm nga aerodromi i nisjes;

b) Aplikantët që kanë një licencë piloti për një kategori tjetër avionësh, me përjashtim të licencës së balonave, do të kreditohen me 10% të kohës totale të fluturimit si PIC në një avion të tillë dhe deri në një maksimum prej shtatë orësh. Shuma e kreditimit të dhënë në çdo rast:

- 1) nuk duhet të përfshijë kërkesat e paragrafëve (a)(2)(ii), (a)(2)(iv)(B) dhe (a)(2)(v)(B); dhe
- 2) në lidhje me paragrafin (a)(2)(iii), nuk duhet të tejkalojë 10 nisje ose ngritje dhe ulje.

SFCL.135 SPL – Provimi i njohurive teorike

a) Njohuritë teorike

Aplikantët për një SPL duhet të demonstrojnë një nivel njohurish teorike që është i përshtatshëm për privilegjet e kërkuara përmes provimeve në sa vijon:

1) lëndë të përbashkëta:

- i. ligji i ajrit;
- ii. performanca njerëzore;
- iii. meteorologjia;
- iv. komunikimet;

2) tema specifike në lidhje me planerat:

- i. parimet e fluturimit;
- ii. procedurat operative;
- iii. performanca dhe planifikimi i fluturimit;
- iv. njohuri të përgjithshme të avionit në lidhje me planerat;
- v. lundrimi;

b) Përgjegjësitë e aplikantit:

1) Aplikanti do të marrë të gjithë grupin e provimeve të njohurive teorike për SPL nën përgjegjësinë e Autoritetit të Aviacionit Civil;

2) Aplikanti do të marrë provimin e njohurive teorike vetëm nëse rekomandohet nga ATO ose DTO, që është përgjegjëse për trajnimin e tij dhe pasi ai të ketë përfunduar elementet e duhura të kursit të trajnimit të njohurive teorike në një standard të kënaqshëm;

3) Rekomandimi nga ATO ose DTO do të jetë i vlefshëm për 12 muaj. Nëse aplikanti ka dështuar të marrë të paktën provimin e njohurive teorike brenda kësaj periudhe vlefshmërie, nevoja për trajnime të mëtejshme do të përcaktohet nga ATO ose DTO, bazuar në nevojat e aplikantit.

c) Standardet kaluese:

1) Një kalim me sukses i provimit të njohurive teorike do t'i jepet aplikantit nëse ai ka arritur të paktën 75% të pikëve të caktuara për atë provim. Nuk do të aplikohet penalitet;

2) Nëse nuk specifikohet ndryshe në këtë Aneks, një aplikant konsiderohet se ka përfunduar me sukses provimin e njohurive teorike të kërkuara për SPL, nëse ai ose ajo ka kaluar të gjitha provimet e kërkuara të njohurive teorike brenda një periudhe prej 18 muajsh të llogaritur nga fundi i muajit kalendarik kur aplikanti u përpoq për herë të parë të merrte provimin;

3) Nëse një aplikant ka dështuar të kalojë një nga provimet e njohurive teorike brenda katër përpjekjeve ose ka dështuar të kalojë të gjitha provimet brenda periudhës së përmendur në paragrafin (2), ai duhet të rimarrë të gjitha provimet e njohurive teorike.

4) Përpara rimarrjes së provimeve të njohurive teorike, aplikanti do të kryejë trajnime të mëtejshme në një ATO ose një DTO. ATO-ja ose DTO-ja do të përcaktojnë shtrirjen dhe qëllimin e trajnimit, bazuar në nevojat e aplikantit.

d) Periudha e vlefshmërisë:

Përfundimi me sukses i provimeve të njohurive teorike do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej 24 muajsh të llogaritur nga dita kur aplikanti ka përfunduar me sukses provimin e njohurive teorike, në përputhje me paragrafin (c) (2).

SFCL.140 SPL – Kreditimi i njohurive teorike

Aplikantët për lëshimin e një SPL do të kreditohen për kërkesat e njohurive teorike për lëndët e zakonshme siç specifikohet në pikën SFCL.135(a)(1) nëse ata:

a) Mbajnë një licencë në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose me aneksin III (pjesa-BFCL) të urdhrit nr. 306, datë 6.12.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”, që përaftron Rregulloren e BE-së nr. 2018/395; ose

b) Kanë kaluar provimet e njohurive teorike për një licencë, siç specifikohet në shkronjën (a), për sa kohë që kjo bëhet brenda periudhës së vlefshmërisë të përcaktuar në pikën SFCL.135(d).

SFCL.145 SPL – Testi praktik i aftësive

a) Aplikantët për një SPL duhet të demonstrojnë përmes përfundimit të një testi aftësie aftësinë për të kryer, si PIC në një planer, procedurat dhe manovrat përkatëse me kompetencë të përshtatshme për privilegjet e kërkuara.

b) Aplikantët duhet të kryejnë testin e aftësive në një planer, duke përjashtuar TMG-të ose një TMG, në varësi të privilegjeve të kërkuara dhe me kusht që kursi i trajnimit, në përputhje me pikën SFCL.130 të përfshijë elementet e nevojshme të trajnimit për avionin përkatës. Një aplikant që ka përfunduar një kurs trajnimi, duke përfshirë elementet e nevojshme të trajnimit si për planerat, ashtu edhe për TMG, mund të kryejë 2 teste aftësish, 1 në planer, me përjashtim të TMG-ve dhe 1 në një TMG, për të marrë privilegje për të dy avionët.

c) Për të marrë një test aftësie për lëshimin e një SPL-je, aplikanti së pari duhet të kalojë provimin e kërkuar të njohurive teorike.

d) Standardet kaluese:

1) testi i aftësisë do të ndahet në seksione të ndryshme, që përfaqësojnë të gjitha fazat e ndryshme të një fluturimi me planer;

2) dështimi në ndonjë artikull të një seksioni do të bëjë që aplikanti të dështojë të gjithë seksionin; nëse aplikanti dështon vetëm në një seksion, ai ose ajo do të përsërisë vetëm atë pjesë; dështimi në më shumë se një seksion do të kërkojë që aplikanti të ribëjë të gjithë testin.

3) nëse aplikanti duhet të bëjë përsëri testin në përputhje me paragrafin (2) dhe dështon në ndonjë seksion, duke përfshirë ato seksione që kanë kaluar në një përpjekje të mëparshme, aplikanti duhet të rimarrë të gjithë testin.

e) Nëse aplikanti nuk arrin të kalojë në të gjitha seksionet e testit brenda dy përpjekjeve, ai ose ajo do të marrë trajnim të mëtejshëm praktik.

SFCL.150 SPL – Privilegjet e planerit dhe TMG-së

a) Nëse testi i aftësisë siç specifikohet në pikën SFCL.145 është përfunduar në një planer, duke përjashtuar TMG-të, privilegjet e një SPL-je do të kufizohen në planera, duke përjashtuar TMG-të.

b) Në rastin e specifikuar në shkronjën (a), privilegjet e një SPL-je do të shtrihen te TMG-të me aplikim nëse një pilot ka:

1) plotësuar në një ATO ose një DTO elementet e trajnimit të specifikuara në pikën SFCL.130(a)(2)(v);

2) kaluar një test aftësie për të demonstruar një nivel të përshtatshëm të aftësive praktike në një TMG. Gjatë këtij testi aftësie, aplikanti duhet t'i demonstrojë, gjithashtu, ekzaminuesit një nivel të mjaftueshëm të njohurive teorike për TMG-të në lëndët e mëposhtme:

i. parimet e fluturimit;

ii. procedurat operative;

iii. performanca dhe planifikimi i fluturimit;

iv. njohuritë e përgjithshme të avionit; dhe

v. lundrimi.

c) Mbajtësit e një licence të lëshuar në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar do të marrin kreditim të plotë për kërkesat në shkronjën (b) me kusht që ata:

1) të mbajnë një kategorizim të klasës për TMG-të; ose

2) kanë privilegje TMG dhe janë në përputhje me kërkesat më të fundit në pikën FCL.140.A të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

d) Nëse testi i aftësisë siç specifikohet në pikën SFCL.145 është përfunduar në një TMG, privilegjet e SPL-së do të kufizohen në TMG;

e) Në rastin e specifikuar në paragrafin (d), privilegjet e SPL-së do të shtrihen te planerat me aplikim nëse një pilot ka:

1) plotësuar në një ATO ose një DTO elementet e trajnimit të specifikuara në pikën SFCL.130(a)(2)(iv) dhe të paktën 15 nisje dhe ulje në një planer, duke përjashtuar TMG-të; dhe

2) kaluar një test aftësie për të demonstruar një nivel të përshtatshëm të aftësive praktike në një planer, duke përjashtuar TMG-të; gjatë këtij testi aftësie, piloti duhet t’i demonstrojë, gjithashtu, ekzaminuesit një nivel të mjaftueshëm njohurish teorike për planerat, duke përjashtuar TMG-të, në lëndët e mëposhtme:

i. parimet e fluturimit;

ii. procedurat operative;

iii. performanca dhe planifikimi i fluturimit;

iv. njohuritë e përgjithshme të avionit; dhe

v. lundrimi.

f) Përfundimi i trajnimit siç specifikohet në paragrafët (b) (1) dhe (e) (1) duhet të regjistrohet në librin e fluturimit (*logbook*) dhe të nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së që është përgjegjës për trajnimin.

SFCL.155 SPL – Metodat e nisjes

a) Mbajtësit e SPL-së do të ushtrojnë privilegjet e tyre vetëm duke përdorur ato metoda të nisjes për të cilat ata kanë përfunduar një trajnim specifik ose gjatë kursit të trajnimit, në përputhje me pikën SFCL.130 ose pikën SFCL.150(e)(1) ose gjatë trajnimit shtesë të ofruar nga një instruktor pas lëshimit të SPL. Ky trajnim specifik do të përbëhet nga sa vijon:

1) në rastin e lëshimit të planerit me çikrik/kabllo (*winch launch*), dhe të lëshimit të planerit me makinë (*car launch*), një minimum prej 10 lëshimesh në instruksione fluturimi dyshe dhe pesë lëshime vetëm nën mbikëqyrje;

2) në rastin e planerave të tërhequr nga një avion tjetër (*aerotow launch*) ose me vetënisje, të paktën pesë lëshime në instruksione fluturimi dyshe dhe pesë lëshime vetëm nën mbikëqyrje. Në rastin e planerave me vetënisje, instruksionet e fluturimit dyshe mund të kryhen në TMG;

3) në rastin e lëshimit me llastik/litar (*bungee*), të paktën tri lëshime të kryera në instruksione fluturimi dyshe ose vetëm nën mbikëqyrje; dhe

4) në rast të metodave të mëtejshme të nisjes, trajnimi siç kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Përfundimi i trajnimit siç specifikohet në paragrafin (a) duhet të regjistrohet në librin e fluturimit (*logbook*) dhe të nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së ose instruktori që është përgjegjës për trajnimin, sipas rastit.

c) Për të ruajtur privilegjet për secilën metodë lëshimi dhe në përputhje me kërkesat e shkronjave (a) dhe (b), mbajtësit e SPL-së duhet të kryejnë të paktën pesë lëshime gjatë dy vjetëve të fundit, me

përrjashtim të lëshimit me litar (*bungee*), rast në të cilin ata do të kryejnë vetëm dy lëshime. Në rastin e vetënisjes, lëshimet mund të bëhen me vetënisje ose nëpërmjet ngritjes në TMG ose një kombinim të tyre.

d) Nëse mbajtësit e SPL-së nuk përmbushin kërkesën në shkronjën (c), për të rinovuar privilegjet e tyre, ata do të kryejnë numrin shtesë të nisjeve duke fluturuar dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një instruktori.

SFCL.160 SPL – Kërkesat e përvojës së fundit

a) Planerat, me përrjashtim të TMG-ve

Mbajtësit e SPL-së do të ushtrojnë privilegje SPL, duke përrjashtuar TMG-të, vetëm nëse në 24 muajt e fundit përpara fluturimit të planifikuar ata kanë:

1) përrfunduar, në planera, të paktën pesë orë kohë fluturimi si PIC ose fluturime dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një FI(S), duke përrfshirë, në planera, me përrjashtim të TMG-ve, të paktën:

i. 15 lëshime; dhe

ii. dy fluturime stërvitore me një FI(S); ose

2) kaluar një kontroll aftësie me një FE(S) në një planer, duke përrjashtuar TMG-të; kontrolli i aftësisë do të bazohet në testin e aftësive për SPL.

b) TMG-të

Mbajtësit e SPL-së do të ushtrojnë privilegjet e tyre TMG vetëm nëse në 24 muajt e fundit përpara fluturimit të planifikuar ata kanë:

1) përrfunduar të paktën 12 orë kohë fluturimi si PIC ose fluturime dyshe ose solo nën mbikëqyrjen e një FI(S), duke përrfshirë, në TMG, të paktën:

i. gjashtë orë kohë fluturimi;

ii. 12 ngritje dhe ulje; dhe

iii. një fluturim stërvitor prej të paktën një orë kohë totale fluturimi me një instruktor; ose

2) kaluar një kontroll aftësie me një ekzaminues; kontrolli i aftësisë do të bazohet në testin e aftësive siç specifikohet në pikën SFCL.150(b)(2).

c) Mbajtësit e SPL me privilegje për të fluturuar në TMG të cilët kanë, gjithashtu, një licencë duke përrfshirë privilegjet për të fluturuar në TMG në përputhje me dispozitat e aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, do të përrjashtohen nga përputhshmëria me shkronjën (b).

d) Përrfundimi i fluturimeve dyshe, fluturimet nën mbikëqyrje dhe fluturimi stërvitor, siç specifikohet në paragrafët (a) (1) dhe (b) (1), si dhe kontrolli i aftësisë siç specifikohet në paragrafin (a) (2) dhe (b) (2) do të regjistrohen në librin e fluturimit (*logbook*) dhe do të nënshkruhen nga përrgjegjësi FI(S) në rastin e paragrafëve (a) (1) dhe (b) (1), dhe nga përrgjegjësi FE(S) në rastin e paragrafëve (a) (2) dhe (b) (2).

e) Transporti i pasagjerëve

Mbajtësit e SPL-së do të transportojnë pasagjerë vetëm nëse në 90 ditët e mëparshme kanë kryer si PIC, të paktën:

1) tri nisje në planera, me përrjashtim të TMG-ve, nëse pasagjerët do të transportohen në planera, me përrjashtim të TMG-ve; ose

2) tri ngritje dhe ulje në TMG, nëse pasagjerët do të transportohen në një TMG; për transportin e pasagjerëve gjatë natës në një TMG, të paktën një nga këto ngritje dhe ulje të jetë kryer gjatë natës.

NËNPJESA ADD KATEGORIZIMET DHE PRIVILEGJET SHITESË

SFCL.200 Privilegje akrobatike

a) Mbajtësit e SPL-së mund të kryejnë vetëm fluturime akrobatike në planera me çdo motor të fikur, ose, në rastin e shkronjës (d) dhe (e), me fuqi motori, nëse ata kanë privilegjet e duhura akrobatike në përputhje me këtë pikë.

b) Privilegjet bazike akrobatike:

1) i japin të drejtë mbajtësit të saj të ndërmarrë fluturime akrobatike të kufizuara në manovrat e mëposhtme:

- i. linja ngjitjeje dhe zhytjeje 45 gradë të kryera si manovra akrobatike;
- ii. cikle të brendshme (*inside loops*);
- iii. ngjitje të pjerrët, e ndjekur nga një kthesë vertikale e sheshtë (*wingover*);
- iv. manovra në formë 8 (*lazy eight*);
- v. rrotullime;

2) përfshihen në privilegjet e një SPL-je pasi një pilot të ketë përfunduar:

i) pas lëshimit të SPL-së, të paktën 30 orë kohë fluturimi ose 120 lëshime si PIC në planera;

ii) një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë:

A) instruksione të njohurive teorike të përshtatshme për privilegjet e kërkuara;

B) instruksione akrobatike të fluturimit për manovrat e specifikuar në paragrafin (1).

c) Privilegjet e avancuara akrobatike:

1) i japin të drejtën mbajtësit të saj të ndërmarrë fluturime akrobatike të pa kufizuara në manovra siç specifikohet në paragrafin (b)(1);

2) përfshihen në privilegjet e një SPL-je pasi një pilot ka:

i. përmbushur kërkesat e paragrafit (b) (2) (i);

ii. ka përfunduar një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë:

A) instruksionet e njohurive teorike të përshtatshme për privilegjet e kërkuara;

B) të paktën pesë orë ose 20 fluturime të instruksionit të fluturimit akrobatik.

d) Privilegjet bazë ose të avancuara akrobatike do të përfshijnë fluturimet akrobatike në planera me fuqi, nëse një pilot ka marrë një trajnim për fluturimin akrobatik në avionë me fuqi motorike gjatë një kursi trajnimi në përputhje me paragrafët (b)(2)(ii) ose (c)(2)(ii), sipas rastit.

e) Privilegjet e një SPL-je do të përfshijnë privilegje të avancuara akrobatike për TMG-të që fluturojnë me fuqi motori nëse një pilot gjithashtu ka ose ka pasur një kategorizim akrobatik në përputhje me pikën FCL.800 të aneksit I (pjesë-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", të ndryshuar, duke përfshirë privilegjet për fluturimet akrobatike TMG.

f) Përfundimi i kursit të trajnimit siç specifikohet në paragrafët (b) (2) (ii) dhe (c) (2) (ii) dhe, sipas rastit, përfshirja e trajnimit të specifikuar në paragrafin (d), do të regjistrohet në librin e fluturimit dhe nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së që është përgjegjës për trajnimin.

SFCL.205 Kategorizimi për tërheqjen e planerave dhe banderolave

a) Mbajtësit e SPL-së që kanë privilegje për të fluturuar me TMG do të tërheqin planera ose banderola, vetëm nëse kanë një kategorizim të përshtatshëm për tërheqjen e planerave ose të banderolave në përputhje me këtë pikë.

b) Aplikantët për një kategorizim për tërheqjen e planerave duhet të kenë plotësuar:

1) të paktën 30 orë kohë fluturimi si PIC dhe 60 ngritje dhe ulje në TMG, pas marrjes së privilegjeve të TMG;

2) një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë:

i. instruksionet e njohurive teorike mbi operimet dhe procedurat e tërheqjes së planerave;

ii. të paktën 10 fluturime stërvitore që tërheqin një planer, duke përfshirë të paktën 5 fluturime trajnimi dyshe;

iii. në rastin e një mbajtësi të SPL-së me privilegje të kufizuara në TMG në përputhje me pikën SFCL.150(d), pesë fluturime familjarizimi në një planer që niset nga një avion.

c) Aplikantët për një kategorizim të tërheqjes së banderolave duhet të kenë plotësuar:

1) të paktën 100 orë kohë fluturimi dhe 200 ngritje dhe ulje si PIC në TMG, pas marrjes së privilegjeve të TMG-së;

2) një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë:

i. instruksionet e njohurive teorike mbi operimet dhe procedurat e tërheqjes së banderolave;

ii. të paktën 10 instruksione fluturimi që tërheqin një banderolë, duke përfshirë të paktën pesë fluturime dyshe.

d) Aplikantët për një kategorizim të tërheqjes së planerit ose një kategorizim të tërheqjes së banderolave, në përputhje me këtë pikë, të cilët tashmë kanë një kategorizim të tërheqjes së planerave ose tërheqjes së banderolave në përputhje me pikën FCL.805(b) të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose që kanë plotësuar të gjitha kërkesat për lëshimin e atij kategorizimi, sipas rastit, do të:

1) marrin kreditim të plotë për kërkesat në shkronjën (b) ose (c) për marrjen e kategorizimit për tërheqjen e planerave ose banderolave, sipas rastit, nëse kategorizimi i tyre përkatës i tërheqjes, siç specifikohet në shkronjën (d) përfshin privilegjet për tërheqjen me TMG; ose

2) kenë përfunduar të paktën tri fluturime instruksione dyshe fluturimi që mbulojnë plan-programin e plotë të trajnimit për tërheqjen e planerit ose banderolave, sipas rastit, në TMG.

e) Përfundimi i kursit të trajnimit siç specifikohet në paragrafët (b) (2), (c) (2) dhe (d) (2) do të regjistrohet në librin e fluturimit dhe nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së ose instruktori që është përgjegjës për trajnimin, sipas rastit.

f) Për të ushtruar privilegjet e kategorizimit për tërheqjen e planerave ose banderolave, mbajtësi i kategorizimit duhet të kryejë të paktën pesë tërheqje gjatë dy vjetëve të fundit.

g) Nëse një mbajtës i kategorizimit për tërheqjen e planerave nuk përputhet me kërkesën në shkronjën (f), përpara se të rifillojë ushtrimin e privilegjeve të tij, ai duhet të plotësojë tërheqjet që mungojnë me ose nën mbikëqyrjen e një instruktori.

SFCL.210 Kategorizimi TMG natën

a) Mbajtësit e SPL-së me privilegje për të fluturuar me TMG do të ushtrojnë privilegjet e tyre TMG në kushte VFR gjatë natës vetëm nëse kanë një kategorizim TMG natën në përputhje me këtë pikë;

b) Aplikantët për kategorizimin e natës TMG fillimisht duhet të përfundojnë një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO. Kursi do të përfshijë:

1) instruksione për njohuri teorike për fluturimin në kushtet e rregullave të fluturimit vizual (VFR) gjatë natës;

2) të paktën pesë orë kohë fluturimi në TMG gjatë natës, duke përfshirë të paktën tri orë instruksione dyshe, duke përfshirë të paktën:

i. një orë lundrim përtej vendit (*crosscountry*) me të paktën 1 fluturim dyshe përtej vendit (*crosscountry*) prej të paktën 50 km (27 NM);

ii. pesë ngritje solo; dhe

iii. pesë ulje solo me ndalesë të plotë.

c) Për të përfunduar trajnimin gjatë natës, një mbajtës i SPL-së së pari duhet të kryejë trajnimin bazë të fluturimit me instrument të nevojshëm për lëshimin e një licence piloti privat (PPL) në përputhje me dispozitat e aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për

miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar.

d) Aplikantët për një kategorizim të natës TMG, në përputhje me këtë pikë do të marrin kreditim të plotë për kërkesat e paragrafëve (b) dhe (c), nëse ata kanë një kategorizim nate në përputhje me pikën FCL.810 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, ose nëse kanë përmbushur të gjitha kërkesat për lëshimin e atij kategorizimi.

SFCL.215 Privilegjet e fluturimit në re me planera

a) Mbajtësit e SPL duhet të operojnë një avion brenda resë vetëm nëse:

- 1) çdo motor është i ndaluar; dhe
- 2) ata kanë privilegje të fluturimit në re me planera në përputhje me këtë pikë.

b) Privilegjet e një SPL do të përfshijnë privilegjet e fluturimit në re me planera nëse një pilot ka kryer të paktën:

- 1) 30 orë si PIC në avionë pas lëshimit të licencës;
- 2) një kurs trajnimi në një ATO ose një DTO, duke përfshirë:

i. mësimin e njohurive teorike;

ii. të paktën dy orë instruksione fluturimi dyshe në planera me çdo motor të fikur, duke e kontrolluar avionin vetëm duke iu referuar instrumenteve; megjithatë, një maksimum prej 50% të udhëzimeve të fluturimit dyshe mund të plotësohet në TMG-të që fluturojnë me fuqi motori, me kusht që këto fluturime stërvitore të kryhen në VMC.

c) Për të marrë privilegjet e fluturimit në re me planera, një mbajtës SPL, i cili, gjithashtu zotëron një kategorizim instrumentesh bazë (BIR) ose një IR(A) në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose që ka përmbushur të gjitha kërkesat për lëshimin e një prej këtyre kategorizimeve duhet:

- 1) të kreditohet kundrejt kërkesave të paragrafit (b) (2) (i);
- 2) me përjashtim të paragrafit (b) (2) (ii), të plotësojë të paktën një orë të instruksionit të fluturimit dyshe në një planer, duke e kontrolluar atë vetëm duke iu referuar instrumenteve.

d) Përfundimi i kursit të trajnimit siç specifikohet në paragrafët (b) (2) ose (c) (2), sipas rastit, do të regjistrohet në librin e fluturimit (*logbook*) dhe do të nënshkruhet nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së që është përgjegjës për trajnimin.

e) Mbajtësit e SPL-së do të ushtrojnë privilegjet e tyre të fluturimit në re me planera vetëm nëse në dy vitet e fundit përpara fluturimit të planifikuar në re, ata kanë përfunduar të paktën një orë kohë fluturimi, ose pesë fluturime, si PIC që ushtron privilegjet e fluturimit në re me planera.

f) Nëse mbajtësit e SPL-së me privilegje të fluturimit në re me planera nuk përmbushin kërkesat në paragrafin (e) dhe ata duan të rifillojnë ushtrimin e privilegjeve të tyre të fluturimit në re me planera, ata duhet:

- 1) të kalojnë një kontroll aftësie me një FE(S); ose
- 2) kryejnë kohën shtesë të fluturimit ose fluturimet e kërkuara në paragrafin (e) me një FI(S).

g) Mbajtësit e SPL-së me privilegje të fluturimit në re me planera, të cilët, gjithashtu, mbajnë një BIR ose një IR(A), në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar do të kreditohen plotësisht për kërkesat e shkronjës (e).

INSTRUKTORËT E FLUTURIMIT

SEKSIONI 1 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

SFCL.300 Certifikata e instruktorit të fluturimit

a) Të përgjithshme

Një instruktor do të kryejë instruksione fluturimi në një planer vetëm nëse ai ose ajo:

1) mban:

i. një SPL duke përfshirë privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat për të cilat duhet të sigurohen instruksionet e fluturimit;

ii. një certifikatë e instruktorit të fluturimit me planer (FI(S)) e përshtatshme për instruksionin e kryer dhe e lëshuar në përputhje me këtë nënpjesë;

2) ka të drejtë të veprojë si PIC në planer gjatë instruksionit të fluturimit.

b) Instruksionet e ofruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

1) me përjashtim të paragrafit (a)(1), në rastin e instruksioneve të fluturimit të ofruara gjatë një kursi trajnimi të miratuar, në përputhje me këtë aneks (pjesa-SFCL) jashtë territorit për të cilin Republika e Shqipërisë është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i lëshojë një certifikatë instruktorit fluturimi një aplikanti që zotëron një licencë pilotimi me planera, që është në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, me kusht që aplikanti:

i. zotëron të paktën një licencë, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, privilegje, kategorizim ose certifikata të barasvlershme me ato për të cilat ai ose ajo është i autorizuar të udhëzojë;

ii. përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë nënpjesë për lëshimin e certifikatës FI(S) me privilegjet përkatëse udhëzuese;

iii. i tregon Autoritetit të Aviacionit Civil një nivel të mjaftueshëm njohurish për rregullat në fuqi të sigurisë së operateve të aviacionit për të qenë në gjendje të ushtrojë privilegjet e tij të instruksionit në përputhje me këtë aneks;

2) certifikata do të kufizohet në ofrimin e instruksioneve të fluturimit:

i. jashtë territorit për të cilin Republika e Shqipërisë është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos;

ii. për një pilot student që ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës në të cilën jepet instruksioni për fluturim.

SEKSIONI 2

CERTIFIKATA E INSTRUKTORIT TË FLUTURIMIT PËR PLANERA – FI(S)

SFCL.315 Certifikata FI(S) – Privilegjet dhe kushtet

a) Në varësi të përputhshmërisë së aplikantëve me pikën SFCL.320 dhe me kushtet e mëposhtme, një certifikatë FI(S) do të lëshohet me privilegje për të kryer instruksione fluturimi, për:

1) një SPL;

2) privilegje shtesë të planerave, në përputhje me pikën SFCL.150(e);

3) metodat e nisjes në përputhje me pikën SFCL.155, me kusht që aplikanti të ketë plotësuar si PIC:

i. në rastin e lëshimit të planerave të tërhequr nga një avion tjetër (*aerotow launch*), të paktën 30 lëshime; ose

ii. në rastin e lëshimit të planerave me çikrik (*winch launch*), të paktën 50 lëshime;

4) privilegje shtesë TMG, në përputhje me pikën SFCL.150(b), me kusht që aplikanti të ketë:

i. përfunduar të paktën 30 orë kohë fluturimi si PIC në TMG;

ii. përfunduar trajnimin, siç specifikohet në pikën SFCL.330(b)(2);

iii. demonstruar aftësinë për të instruktuar mbi TMG-të një FI(S), i cili është i kualifikuar në përputhje me paragrafin (7) dhe i emëruar nga drejtuesi i trajnimit të ATO-s ose DTO-së;

5) Privilegjet bazë akrobatike, akrobatike të avancuara ose të fluturimit në re me planera, ose kategorizimi i tërheqjes së planerit ose i tërheqjes së banderolave, me kusht që aplikanti:

i. në rastin e instruksioneve për privilegje akrobatike bazë ose të avancuara, ka privilegje të avancuara akrobatike, në përputhje me pikën SFCL.200(c);

ii. ka demonstruar aftësinë për të instruktuar për privilegjet ose kategorizimin përkatës një FI(S), i cili është kualifikuar në përputhje me paragrafin (a)(7) dhe i emëruar nga drejtuesi i trajnimit të një ATO-je ose një DTO-je;

6) Fluturime TMG natën, me kusht që aplikanti:

i. përputhet me kërkesën për eksperiencën e natës në pikën SFCL.160(e)(2);

ii. ka demonstruar aftësinë për të instruktuar në TMG-të gjatë natës një FI (S), i cili është i kualifikuar në përputhje me paragrafin (7) dhe i emëruar nga drejtuesi i trajnimit të një ATO-je ose një DTO-je;

7) një certifikatë FI(S), me kusht që aplikanti të ketë:

i) kryer të paktën 50 orë ose 150 nisje të instruksioneve të fluturimit në planera;

ii. ka demonstruar aftësinë për të instruktuar për certifikatën FI(S) një FI(S), i cili është kualifikuar në përputhje me këtë paragraf dhe i emëruar nga drejtuesi i trajnimit të një ATO-je ose një DTO-je, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Privilegjet e renditura në shkronjën (a) do të përfshijnë privilegjet për të kryer instruksione fluturimi për:

1) lëshimin e licencës, privilegjeve, kategorizimeve ose certifikatës përkatëse; dhe

2) rivalidimin, rinovimin ose pëputhshmërinë me kërkesat përkatëse të eksperiencës së fundit të këtij aneksi, sipas rastit.

SFCL.320 Certifikata FI(S)– Parakushtet dhe kërkesat

Aplikantët për një certifikatë FI(S) duhet:

a) të jetë së paku 18 vjeç;

b) të jenë në përputhje me kërkesat e pikës (a) (1) (i) dhe paragrafit (2) të pikës SFCL.300;

c) të kenë përfunduar 100 orë kohë fluturimi dhe 200 lëshime si PIC në planera;

d) të kenë përfunduar një kurs trajnimi për instruktorë në përputhje me pikën SFCL.330 në një ATO ose një DTO; dhe

e) të kenë kaluar vlerësimin e kompetencës në përputhje me pikën SFCL.345.

SFCL.325 FI(S) Kompetencat dhe vlerësimi

Aplikantët për një certifikatë FI(S) do të trajnohen për të arritur kompetencat e mëposhtme:

a) përgatitjen e burimeve;

b) krijimin e një klimë të favorshme për të mësuar;

c) njohuritë aktuale;

d) integrimi i menaxhimit të kërcënimeve dhe gabimeve (TEM) dhe menaxhimit të burimeve të ekuipazhit (CRM);

e) menaxhimi i kohës për të arritur objektivat e trajnimit;

f) lehtësimi i mësimi;

g) vlerësimi i performancës së praktikantit;

h) monitorimi dhe rishikimi i progresit;

i) vlerësimi i seancave të trajnimit; dhe

j) raportimi i rezultatit.

SFCL.330 FI(S) – Kursi i trajnimit

a) Aplikantët për një certifikatë FI(S), së pari duhet të kalojnë një vlerësim specifik para hyrjes në një ATO ose një DTO, brenda 12 muajve para fillimit të kursit të trajnimit, për të vlerësuar aftësinë e tyre për të ndjekur kursin.

b) Kursi i trajnimit FI(S) do të përfshijë:

1) në planera, me përjashtim të TMG-ve:

i. elementet e specifikuara në pikën SFCL.325;

ii. 25 orë mësimdhënie dhe mësimnxënie;

iii. 30 orë mësim të njohurive teorike, duke përfshirë testet e progresit;

iv. të paktën gjashtë orë, nga të cilat maksimumi tri orë mund të kryhen në TMG, ose 20 nisje të instruksioneve të fluturimit;

2) përveç kësaj, nëse privilegjet e certifikatës FI(S) do të përfshijnë privilegjet e specifikuara në pikën SFCL.315(a)(4) dhe (a)(6), të paktën gjashtë orë instruksione dyshe fluturimi në TMG.

c) Aplikantët që tashmë kanë një certifikatë instruktori në përputhje me aneksin III (pjesa-BFCL) të Rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat” që përaftron Rregulloren e BE-së nr. 2018/395, ose me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, do të kreditohen plotësisht për kërkesën në paragrafin (b)(1)(ii).

d) Kur aplikon për një certifikatë FI(S), një pilot që mban ose ka mbajtur një FI(A), (H) ose (As) do të kreditohet me 18 orë në përputhje me kërkesat në paragrafin (b)(1)(iii).

SFCL.345 FI(S) – Vlerësimi i kompetencës

a) Aplikantët për lëshimin e një certifikate FI(S) duhet të kalojnë një vlerësim të kompetencës për t’i demonstruar një ekzaminuesi të kualifikuar, në përputhje me pikën SFCL.415(c) aftësinë për të instruktuar një student pilot në nivelin e kërkuar për lëshimin e një SPL-je.

b) Vlerësimi do të përfshijë:

1) demonstrimin e kompetencave të përshkruara në pikën SFCL.325, para fluturimit, pas fluturimit dhe njohurive teorike;

2) provimet teorike me gojë në tokë, informime/*briefings* para dhe pas fluturimit, dhe demonstrime gjatë fluturimit në planera;

3) ushtrime të përshtatshme për të vlerësuar kompetencat e instruktorit.

c) Vlerësimi i kompetencës për lëshimin fillestar të një certifikatë FI(S) do të kryhet në planera, duke përjashtuar TMG-të.

SFCL.350 FI(S) – Privilegjet e kufizuara

a) Një FI(S) do të ketë privilegjet e tij të kufizuara në kryerjen e instruksioneve të fluturimit nën mbikëqyrjen e një FI(S) të pakufizuar të emëruar nga ATO ose DTO për këtë qëllim, në rastet e mëposhtme:

1) për lëshimin e një SPL-je;

2) për zgjerimin e privilegjeve të një SPL-je në privilegjet shtesë të planerave ose TMG, në përputhje me pikën SFCL.150;

3) për zgjerimin e privilegjeve të një SPL-je në metoda shtesë të lëshimit në përputhje me pikën SFCL.155; dhe

4) për privilegjet bazë akrobatike, aerobatika të avancuara ose të fluturimit në re me planera, ose për kategorizimin e tërheqjes së planerit ose të tërheqjes së banderolave.

b) Gjatë kryerjes së trajnimit nën mbikëqyrje, në përputhje me paragrafin (a), FI(S) nuk do të ketë privilegjin të autorizojë një student pilot që të kryejë fluturimin e tij të parë solo ose fluturimin e parë solo përtej vendit (*crosscountry*).

c) Kufizimet në shkronjat (a) dhe (b) do të hiqen nga certifikata FI(S) pasi FI(S) të ketë përfunduar të paktën 15 orë ose 50 nisje të instruksioneve të fluturimit që mbulojnë të gjitha fazat e një fluturimi me planer. Në rastin e një FI(S) të kufizuar që është në përputhje me pikën SFCL.330(b)(2), 5 nga ato 15 orë mund të kryhen në TMG dhe 15 nga ato 50 nisje mund të zëvendësohen me ngritje dhe ulje në TMG.

SFCL.360 Certifikata FI(S) – Kërkesat e përvojës së fundit

a) Një mbajtës i certifikatës FI(S) do të ushtrojë privilegjet e certifikatës së tij vetëm nëse përpara ushtrimit të planifikuar të këtyre privilegjeve ai ka përfunduar:

1) brenda tre vjetëve të fundit:

i. trajnimin rifreskues për instruktor në një ATO, një DTO, ose një autoritet kompetent gjatë të cilit mbajtësi do të marrë instruksione teorike të njohurive për rifreskimin dhe përditësimin e njohurive të rëndësishme për instruktorët e planerave; dhe

ii. kur jep instruksione fluturimi si FI(S), të paktën:

A) 30 orë; ose

B) 60 nisje ose ngritje dhe ulje; dhe

2) brenda nëntë vjetëve të fundit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ka demonstruar aftësinë për të instruktuar në planera për një FI(S), i cili është kualifikuar në përputhje me pikën SFCL.315(a)(7) dhe të jetë i emëruar nga drejtuesi i trajnimit të një ATO-je ose një DTO-je

b) Orët e fluturimit si FE(S) gjatë testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës do të kreditohen plotësisht në përputhje me kërkesën në paragrafin (a) (1) (ii).

c) Nëse mbajtësi i certifikatës FI(S) ka dështuar në përfundimin e instruksioneve të fluturimit nën mbikëqyrjen dhe bindjen e FI(S), në përputhje me paragrafin (a)(2), ai nuk do të ushtrojë privilegjet e certifikatës FI(S) derisa të ketë përfunduar me sukses një vlerësim të kompetencës, në përputhje me pikën SFCL.345.

d) Për të rifilluar ushtrimin e privilegjeve të certifikatës FI(S), një mbajtës i certifikatës FI(S) që nuk përmbush të gjitha kërkesat në shkronjën (a) duhet të përmbushë kërkesat e paragrafit (a)(1)(i) dhe të pikës SFCL.345.

NËNPJESA FE EKZAMINUESIT E FLUTURIMIT

SEKSIONI 1 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

SFCL.400 Certifikatat e ekzaminuesit të fluturimit me planera

a) Të përgjithshme

Një ekzaminues do të kryejë vetëm teste aftësish, kontrolle të aftësisë ose vlerësime të kompetencës në përputhje me këtë aneks, nëse ai:

1) mban:

i. një SPL që përfshin privilegjet, kategorizimet dhe certifikatat për të cilat ai është i autorizuar të kryejë teste aftësie, kontrolle të aftësisë ose vlerësime të kompetencës dhe privilegjet për të instruktuar për ato;

ii. një certifikatë FE(S) që përfshin privilegjet e përshtatshme për testin e aftësive, kontrollin e aftësisë ose vlerësimin e kompetencës të kryer, të lëshuar në përputhje me këtë nënpjesë;

2) ka të drejtë të veprojë si PIC në një planer gjatë testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës.

b) Provimet e kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

1) me përjashtim të paragrafit (a)(1), në rastin e testeve të aftësive dhe kontrolleve të aftësisë të kryera jashtë territorit për të cilin Republika e Shqipërisë është përgjegjëse sipas Konventës së Çikagos, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i lëshojë një certifikatë ekzaminuesi një aplikanti që zotëron një licencë piloti për planer, që është në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos, me kusht që aplikanti:

i. zotëron të paktën një licencë, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, privilegje, kategorizimet ose certifikata të barasvlershme me ato për të cilat ai është i autorizuar të kryejë teste aftësish ose kontrolle aftësie;

ii. përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë nënpjesë për lëshimin e certifikatës përkatëse të ekzaminuesit;

iii. i tregon Autoritetit të Aviacionit Civil një nivel të mjaftueshëm njohurish për rregullat kombëtare të sigurisë në operim, për të qenë në gjendje të ushtrorë privilegjet e ekzaminuesit, në përputhje me këtë aneks;

2) certifikata e përmendur në paragrafin (1) do të kufizohet në kryerjen e testeve të aftësive dhe kontrolleve të aftësisë:

i. jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe

ii. për një pilot që ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës në të cilën ofrohet testi/kontrolli.

SFCL.405 Kufizimi i privilegjeve në rast të konfliktit të interesit

Ekzaminuesi i planerave nuk duhet të kryejë:

a) një test aftësie ose vlerësim të kompetencës së një aplikanti për lëshimin e një licence, kategorizimi ose certifikate, të cilit ai i ka dhënë më shumë se 50% të instruksioneve të nevojshme të fluturimit për licencën, kategorizimin ose certifikatën për të cilën testi i aftësive ose vlerësimi i kompetencës është marrë; ose

b) një test aftësie, kontroll aftësie ose vlerësim të kompetencës sa herë që ai ose ajo mendon se objektiviteti i tij ose i saj mund të preket.

SFCL.410 Kryerja e testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës

a) Gjatë kryerjes së testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës, një ekzaminues i planerit duhet të bëjë të gjitha sa vijon:

1) të sigurojë që komunikimi me aplikantin të mund të vendoset pa pengesa gjuhësore;

2) të verifikojë që aplikanti përmbush të gjitha kërkesat e kualifikimit, trajnimit dhe eksperiencën të këtij aneksi për lëshimin, rivlerësimin ose rinovimin e licencës, privilegjeve, kategorizimit ose certifikatës për të cilën është kryer testi i aftësisë, kontrolli i aftësisë ose vlerësimi i kompetencës;

3) ndërgjegjësojë aplikantin për pasojat e dhënies së informacionit jo të plotë, të pasaktë ose të rremë, në lidhje me eksperiencën e tij të trajnimit dhe fluturimit.

b) Pas përfundimit të testit të aftësisë, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës, ekzaminuesi i planerit duhet:

1) të informojë aplikantin për rezultatet e testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës;

2) në rast të kalimit në një vlerësim të kompetencës për rivlerësimin ose rinovimin, të miratojë datën e re të skadencës në licencën ose certifikatën e aplikantit, nëse autorizohet në mënyrë specifike për këtë qëllim nga autoriteti kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit;

3) t'i sigurojë aplikantit një raport të nënshkruar të testit të aftësisë, të kontrollit të aftësisë ose të vlerësimit të kompetencës dhe t'i dorëzojë pa vonesë të panevojshme kopjet e raportit autoritetit kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit dhe autoritetit kompetent që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit. Raporti do të përfshijë:

i. një deklaratë se ekzaminuesi i planerit ka marrë informacion nga aplikanti, në lidhje me përvojën dhe instruksionet dhe ka konstatuar se përvoja dhe Instruksionet përputhen me kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi;

ii. konfirmimin se janë kryer të gjitha manovrat dhe ushtrimet e kërkuara, si dhe informacionin për provimin me gojë të njohurive teorike, kur është e mundur; nëse një pjesë ka dështuar, ekzaminuesi regjistron arsyet për këtë vlerësim;

iii. rezultatin e testit të aftësive, kontrollit të aftësisë ose vlerësimit të kompetencës;

iv. një deklaratë se ekzaminuesi i planerit ka shqyrtuar dhe zbatuar procedurat kombëtare dhe kërkesat e autoritetit kompetent të aplikantit nëse autoriteti kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit;

v. një kopje të certifikatës së ekzaminuesit të planerave që përmban fushëveprimin e privilegjeve të tij, si ekzaminues i planerit në rastin e testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit.

c) Ekzaminuesi i planerave duhet të mbajë të dhënat për pesë vjet me detaje të të gjitha testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë dhe vlerësimeve të kompetencës së kryer dhe rezultateve të tyre.

d) Me kërkesë të autoritetit kompetent që është përgjegjës për certifikatën e ekzaminuesit të planerave, ose autoritetit kompetent që është përgjegjës për licencën e aplikantit, ekzaminuesi i planerave duhet të dorëzojë të gjitha shënimet dhe raportet, si dhe çdo informacion tjetër, sipas nevojës, për aktivitetet e mbikëqyrjes.

SEKSIONI 2

CERTIFIKATA E EKZAMINUESIT TË FLUTURIMIT PËR PLANERA – FE(S)

SFCL.415 FE(S) Certifikata – Privilegjet dhe kushtet

Në varësi të përputhshmërisë së aplikantit me pikën SFCL.420 dhe me kushtet e mëposhtme, një certifikatë FE(S) do të lëshohet pas aplikimit me privilegje:

a) për të kryer testet e aftësive dhe kontrollet e aftësisë për SPL, me kusht që aplikanti të ketë kryer, në planera, duke përjashtuar TMG, 300 orë kohë fluturimi si pilot, duke përfshirë 150 orë ose 300 nisje të instruksioneve të fluturimit;

b) për të kryer testet e aftësive për zgjerimin e privilegjeve të SPL në TMG në përputhje me pikën SFCL.150(e), me kusht që aplikanti të ketë kryer 300 orë kohë fluturimi në planera, duke përfshirë 50 orë instruksione fluturimi në TMG;

c) për të kryer vlerësimet e kompetencës për lëshimin e certifikatave FI(S) në planera, me kusht që aplikanti të ketë:

1) përfunduar të paktën 500 orë kohë fluturimi si pilot në planera, duke përfshirë, nëse privilegjet e certifikatës FE(S) do të ushtrohen në:

i. planera, duke përjashtuar TMG-të, të paktën 10 orë ose 30 lëshime duke instruktuar aplikantin për një certifikatë FI(S) në planera, duke përjashtuar TMG-të;

ii. TMG, të paktën 10 orë ose 30 ngritje dhe ulje që instruktojnë aplikantin për një certifikatë FI(S) në TMG;

2) marrë trajnim specifik gjatë një kursi standardizimi për ekzaminues në përputhje me pikën SFCL.430.

SFCL.420 Certifikata FE(S) – Parakushtet dhe kërkesat

Aplikantët për një certifikatë FE(S) duhet:

a) të jenë në përputhje me kërkesat e pikës (a) (1) (i) dhe paragrafit (a) (2) të pikës SFCL.400;

b) të kenë përfunduar kursin e standardizimit FE(S) në përputhje me pikën SFCL.430;

c) të kenë përfunduar një vlerësim të kompetencës në përputhje me pikën SFCL.445;
d) të demonstrojnë *background* përkatës, në lidhje me privilegjet e certifikatës FE(S); dhe
e) të demonstrojnë se ata nuk u janë nënshtruar asnjë sanksioni, duke përfshirë pezullimin, kufizimin ose revokimin e ndonjë prej licencave, kategorizimeve ose certifikatave të tyre të lëshuara në përputhje me këtë aneks, me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, ose me aneksin III (pjesa-BFCL) të urdhrit nr. 306, datë 6.12.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”, që përafron Rregulloren e BE-së nr. 2018/395, për mospërputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij gjatë tre vjetëve të fundit.

SFCL.430 Certifikata FE(S) – Kursi i standardizimit

a) Aplikantët për një certifikatë FE(S) do të ndjekin një kurs standardizimi, i cili ofrohet ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga një ATO ose një DTO të miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Kursi i standardizimit do t’u përshtatet privilegjeve të kërkuara të ekzaminuesit të fluturimit me planer dhe do të përbëhet nga instruksione teorike dhe praktike, duke përfshirë të paktën:

1) kryerjen e dy testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës për SPL ose kategorizimet ose certifikatat përkatëse;

2) instruksione për kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi dhe kërkesat e zbatueshme të operimeve ajrore, kryerjen e testeve të aftësive, kontrollet e aftësisë dhe vlerësimet e kompetencës, si dhe dokumentacionin dhe raportimin e tyre;

3) një përmbledhje për sa vijon:

i. procedurat administrative kombëtare;

ii. kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale;

iii. përgjegjësinë e ekzaminuesit;

iv. sigurimin e aksidentit të ekzaminuesit;

v. tarifat kombëtare; dhe

vi. informacionin mbi mënyrën e aksesit në informacionin e përfshirë në pikat (i) deri (v) gjatë kryerjes së testeve të aftësive, kontrolleve të aftësisë ose vlerësimeve të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesi.

c) Një mbajtës i certifikatës FE(S) nuk do të kryejë teste aftësish, kontrolle aftësie ose vlerësime të kompetencës së një aplikanti, autoriteti kompetent i të cilit nuk është ai që ka lëshuar certifikatën e ekzaminuesit, përveç nëse ai ka shqyrtuar informacionin më të fundit të disponueshëm, që përmban procedurat përkatëse kombëtare të autoritetit kompetent të aplikantit.

SFCL.445 Certifikata FE(S) – Vlerësimi i kompetencës

Një aplikant për lëshimin fillestar të një certifikate FE(S) duhet të demonstrojë kompetencat e tij si FE(S), të një inspektor nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose të një ekzaminuesi i lartë i autorizuar në mënyrë specifike për ta bërë këtë nga Autoriteti i Aviacionit Civil që është përgjegjës për certifikatën FE(S). Gjatë vlerësimit të kompetencës, aplikanti do të kryejë një test aftësie, kontroll të aftësisë ose vlerësim të kompetencës, duke përfshirë informimin, zhvillimin e testit të aftësisë, kontrollin e aftësisë ose vlerësimin e kompetencës, dhe vlerësimin e personit të cilit i bëhet testi, kontrollin ose vlerësimin, raportimin dhe regjistrimin e dokumentacionit.

SFCL.460 Certifikata FE(S) – Vlefshmëria, rivlerësimi dhe rinovimi

a) Një certifikatë FE(S) do të jetë e vlefshme për pesë vjet.

b) Një certifikatë FE(S) do të rivlerësohet nëse mbajtësi i saj:

1) gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës FE(S), ka përfunduar një kurs rifreskues të ekzaminuesit, i cili ofrohet ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga një ATO ose një DTO i miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, gjatë të cilit mbajtësi do të marrë instruksione teorike të njohurive për rifreskimin dhe përditësimin e njohurive të rëndësishme për ekzaminuesit e planerave;

2) brenda 24 muajve të fundit para përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës, ka kryer një test aftësie, kontroll të aftësisë ose vlerësim të kompetencës nën mbikëqyrjen dhe bindjen e një inspektori nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose një ekzaminues i autorizuar në mënyrë specifike për ta bërë këtë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që është përgjegjës për certifikatën FE(S).

c) Një mbajtës i certifikatës FE(S), i cili, gjithashtu, zotëron një ose më shumë certifikata ekzaminuesi për kategori të tjera avionësh në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar ose me aneksin III (pjesa-BFCL) të urdhrit nr. 306, datë 6.12.2024, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”, që përafrojnë Rregulloren e BE-së nr. 2018/395, mund të arrijë rivalidimin e kombinuar të të gjitha certifikatave të ekzaminuesit të mbajtura, në marrëveshje me Autoritetin e Aviacionit Civil.

d) Nëse një certifikatë FE(S) ka skaduar, mbajtësi i saj duhet të përmbushë kërkesat e paragrafit (b)(1) dhe të pikës SFCL.445 përpara se ai të rifillojë ushtrimin e privilegjeve të certifikatës FE(S).

e) Një certifikatë FE(S) do të rivlerësohet ose rinovohet vetëm nëse aplikanti demonstroi përputhshmëri të vazhdueshme me kërkesat e pikës SFCL.410, si dhe me kërkesat e pikës SFCL.420(d) dhe (e).